

THESARE

MJET FRYMËZIMI DHE UDHËRRËFYES PËR PASTORËT DHE SHËRBYESIT

numri 16 / pranverë 2019

Editorial 2

Gëzim Spahija

5 Arsye Pse Kishat e 4

**Themeluara Duhet
të Mbjellin Kisha**

Kurt Plagenhoef

Gratë në Shërbesë 10

Një Komunitet i Thirrur

Judy Rachels

Fryma e Zotit Është 13

**Mbi Mua: Vërtetimi nga
Perëndia për Shërbesë**

Beth Grant

Jezusi dhe Gratë 19

Doug Clark

Mentorimi: 26

I Panegociueshëm

Për Fuqizimin e

Grave në Shërbesë

Karen Yancey

Konferenca 33

Kombëtare e

Burrave

Fatjon Kadiu & Kurt Plagenhoef

Tema: Gratë në Shërbesë - Vërtetimi nga Perëndia



Gratë në Shërbesë Vërtetimi nga Perëndia

Nuk do të mund ta kuptonim sadopak rolin dhe kontributin e gruas në shërbesë, në qoftë se këtë nuk do të mund ta shikonim nën dritën e krijimit dhe vlerësimit të Perëndisë. Tek Zan. 1:27 thuhet: "Kështu Perëndia krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së vet, sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë e krijoi; Ai i krijoi mashkull e femër". Të dy si një person i vetëm, të parë në sytë e Perëndisë, duke plotësuar në mënyrë të përsosur njëri-tjetrin në çdo aspekt të jetës e shërbesës së tyre.

Satani, qysh në fillim e deri më sot, ka kërkuar dhe kërkon që ta vendosë në dyshim dhe ta denigrojë rolin e gruas. Ai, duke e ditur forcën, përkushtimin, vetëmohimin, përfshirjen dhe kontributin e gruas në shërbesën e Perëndisë, e ka frikë atë dhe për këtë arsye kërkon që të nënvleftësojë sa të mundet rolin e saj. Që në momentin kur Jezusi, biri i Perëndisë erdhi në këtë botë dhe deri në orët e fundit para se të kthehej në qiell, gratë ishin të përfshira plotësisht në shërbesën e Jezusit. Në çdo gjë që Ai tha dhe bëri, ishte edhe synimi që të rikthente në vend dinjitetin e gruas, i cili ishte mohuar e nëpërkëmbur nga ligjet e zakonet hebraike. Ai e trajtoi atë si të barabartë me burrat, dhe për këtë refuzoi dhe luftoi fort që të ndiqte rregullat kundër grave, të vendosura nga farisenjtë.

Fjala e Zotit është e mbushur plot me shembuj të grave të perëndishme, të cilat u përdorën nga

Perëndia në të njëjtën mënyrë si burrat. Pa rolin dhe kontributin e gruas në shërbesë, do të ishte e vështirë apo ndoshta edhe e pamundur që shërbesa e Zotit të ecte përpara. Lavdi Zotit që në realitetin e kishave tona, Perëndia ka shpëtuar dhe ka thirrur shumë gra e motra të bekuara dhe të vajosura për shërbesën e Tij! Ato kanë një rol kyç në pjesën më të madhe të shërbesave që kryhen në kishë, si me fëmijët, motrat, adoleshentët, të rinjtë, ungjillizimin, vizitat, ndarjet e Fjalës apo projekte të ndryshme sociale. Shumë nga ato, tani janë promotore të shumë iniciativave frytdhënëse në aspektin e shërbesës.

Personalisht jam i inkurajuar nga gratë e drejtuesve në lëvizjen tonë, dhe pajtohem plotësisht me atë që dikush ka thënë, se: "Pas drejtuesi të suksesshëm qëndron gjithmonë një grua e perëndishme". Duhet vërtet që të jemi duke u bekuar nga këto potenciale që na janë dhënë dhuratë nga Perëndia, sepse bekimi dhe vlerësimi i Tij qëndron mbi to.



GËZIM SPAHIJA, Drejtor Ekzekutiv, Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë të Shqipërisë.

THESARE

Numri 16
Pranverë 2019

Koordinatorë e projektit: Stephanie Plagenhoef
Përkthyes: Fabian Tozharaku
Redaktues: Skënder Hoxha
Grafika kompjuterike: Lindita Sqapi

Botuar nga:
Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë të Shqipërisë

Në bashkëpunim me:
Life Publishers International

Adresa: K.P. 119 / Kutia 2 / Tirana, Albania

Cel: (+355) 69-406-8956

Email: KTUShqiperi@gmail.com



Artikujt e zgjedhur dhe grafika përshtatur nga revista Enrichment - ©Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë, ShBA. Përdorur me leje.

©Life Publishers International. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

studentët krishtin

students for christ
europe

**Ofron trainim për të gjithë pastorët,
bashkëpunëtorët dhe individët me një dëshirë për të
ungjillizuar dhe dishepullizuar studentët e universitetit.**



12-15 mars 2019

**Prezantuar nga BLAIR BONIN dhe
Mandati Global i Asambleve të Perëndisë**

**Trainimi fillon në mbrëmjen e datës 12 dhe
përfundon mbas mëngjesit të datës 15.**

**Vendi ku zhvillohet trainimi dhe fjetja (nëse keni nevojë):
KOLEGJI TEOLOGJIK UNGJILLOR
Farkë, Tiranë**

**Për t'u regjistruar kontaktoni
Emanuele Mango: 069-609-5810**

<https://www.sfceurope.org>





5 ARSYE

pse

Kishat e Themeluara

Duhet të Mbjellin Kisha

Nga: KURT PLAGENHOEF

Unë besoj te kishëmbjellja.
Kur erdha në Shqipëri në
vitin 1995, e dija se
Perëndia më kishte thirrur
për të predikuar ungjillin,
për të fituar të humburit dhe
për të mbjellë kisha. Pasi
kaluam një vit në Tiranë, për
të mësuar gjuhën, Zoti na
drejtoi për të mbjellë një
kishë në Fushë Krujë, në një
vend ku nuk ekzistonte
asnjë kishë ungjillore.

U

në dhe gruaja ime e filluam duke u lutur dhe duke agjëruar, dhe duke bërë ungjillëzim individual nëpër shtëpi; si dhe përmes shërbesave dhe shumë mënyrave të tjera ungjillëzuese. Eventualisht, të konvertuarit e parë e vendosën besimin e tyre tek Krishti dhe një kishë erdhi në jetë, e cila vazhdon edhe sot e kësaj dite. Kishëmbjellja është punë e lodhshme, njësoj si të plugosh dhe të mbjellësh një arë të re, por sa gëzim i madh është teksa shohim Perëndinë, i cili bën mrekulli duke ndryshuar jetë dhe duke ngritur një kishë nga asgjëja.

Përveç zellit që kam për kishëmbjelljen, unë jam gjithashtu i zjarrtë edhe për kishat e forta e të themeluara. Shumë kisha të reja duhet të mbillen, ashtu siç duhet të rigjallërohen edhe disa kisha të themeluara. Por, edhe pse disa persona mund t'i shohin këto të dyja si ngjarje të cilat ndodhin veç e veç, mua më emocionon më shumë pjesa ku këto të dyja mbulojnë njëra-tjetrën, pra, kishat e themeluara që mbjellin kisha të reja.

Pastorët e kishave të themeluara duhet të angazhohen në kishëmbjellje! Më poshtë gjeni pesë arsye pse.

K

ishëmbjellja arrin njerëzit e humbur.

Arsyeja e parë është e thjeshtë, dhe të gjithë pastorët mund të bien dakord me të. Të humburit kanë nevojë për Jezusin, dhe tashmë **është fakt i njohur se më shumë njerëz të humbur vijnë tek Krishti përmes kishëmbjelljes sesa përmes mënyrave të tjera**. Kishëmbjelljet sjellin emocione, vizion, mundësi dhe jetë të re.

Për mua ka një domethënie të veçantë. Unë jam rritur në një kishë të krishterë tradicionale në Amerikë, por nuk mund të mbaj mend asnjë rast që të kem dëgjuar ungjillin apo të jem sfiduar për të marrë një vendim personal për t'u penduar për mëkatet e mia, për të vendosur besimin tek Krishti dhe për ta pranuar Jezusin si Zotin dhe Shpëtimtarin tim. Shpëtimi është i thjeshtë, por në qoftë se nuk dëgjon personalisht për të, atëherë mund të jetë shumë i largët. Nëna ime e dëgjoji ungjillin përmes një kishëmbjelljeje të re pentekostale në qytetin tonë dhe u bë një ndjekëse e Jezusit. Pastaj, ajo e ndau ungjillin me mua. Ungjilli është bërë për t'u ndarë me të tjerët. Gjithashtu, ungjilli është fuqia e Perëndisë për të ndryshuar jetë, martesë, familje dhe shoqëri. Jeta ime ndryshoi!

Para disa vitesh, revista "Krishterimi sot" (Christianity Today) publikoi një artikull me titullin: "Shkoni dhe mbillni kisha në të gjitha kombet" (Go and Plant Churches of All Peoples), ku thuhej se tani mënyra ungjillëzuese e preferuar në Amerikën Veriore, ishte kishëmbjellja, e cila kishte zëvendësuar ungjillëzimin e masave. Kishëmbjellja ka përjetuar aq shumë rritje, sa që në disa raste, është e vështirë që të gjesh njerëz të cilët dëshirojnë të rigjallërojnë kishat më të vjetra e të themeluara, për shkak se ka qaq shumë njerëz që duan të mbjellin kisha të reja.

Në kontekstin tonë shqiptar, ku kishat e para janë mbjellë gjatë dekadës pas rënies së komunizmit në vitin 1991, ne ende kemi të bëjmë me një kishë të brezit të parë. Shumë prej studentëve që ndjekin Kolegjin Teologjik Ungjillor, shkollën tonë biblike në Tiranë, janë besimtarët e vetëm në familjet e tyre. Ky realitet po ndryshon dalëngadalë përgjatë viteve pasi më shumë anëtarë të familjes po vijnë në besim. Është një gëzim i madh të shohim të rinj dhe të reja që kanë pranuar Krishtin kur ishin edhe më të rinj dhe tani janë martuar, kanë fëmijë dhe ua kalojnë besimin e krishterë edhe atyre. Një ditë e re dhe një brez i ri ka ardhur tashmë. Shumica e kishëmbjellësve nxiten nga një pasion për t'i parë të humburit që të vijnë tek Krishti dhe të sjellin një ndryshim në komunitetin e tyre.

I sfidoj pastorët e kishave të themeluara që të jenë kisha mëmë e një kishëmbjelljeje. Do të shihni që do të fitoni njerëz për Krishtin, si në kishën që do të mbillni ashtu edhe në kishën tuaj. Disa persona, të cilët mund të jenë më pak të tërhequr nga kisha juaj, mund të tërhiqen më tepër nga kishëmbjellja juaj. Siç ndryshojnë kishat, ndryshojnë edhe njerëzit që ato arrijnë. Për këtë arsye, ne duam të mbjellim kisha që shumëfishohen duke mbjellë kisha të tjera.

K

ishëmbjellja ndjek një model biblik.

Ndërsa studiojmë Dhjatën e Re, e shohim kishëmbjelljen si një model tashmë të themeluar. Bibla nuk e përdor kurrë termin "kishëmbjellje", dhe as nuk e përmend shprehimisht togfjalëshin "mbjellja e kishave", por është qartësisht e kuptueshme se ky është modeli i Dhjatës së Re. Kjo është pikërisht gjëja e parë që bënë dishepujt kur iu përgjigjën Porosisë së Madhe të Jezusit. Ata e predikuan ungjillin, i mblodhën bashkë besimtarët e rinj për të adhuruar dhe për t'i dishepullizuar, dhe kështu, mbollën kisha.

Shumica e kishave që janë përmendur në Dhjatën e Re kanë qenë të përfshira me dërgimin e njerëzve, në një mënyrë apo në një tjetër, për të filluar kisha të tjera. Si për ironi, kisha e Jerusalemit përbënte një përjashtim. Ata dërgonin njerëz për të kontrolluar kishat e reja, duke inkurajuar drejtuesit e rinj dhe duke u siguruar që ata po i qëndronin besnikë ungjillit të vërtetë të Krishtit.

Thirrja apostolike e Palit e shtyu atë jashtë Jerusalemit për t'ua predikuar ungjillin johebrenjve, atyre që nuk kishin askënd që t'u dëshmonte rreth lajmit të mirë, dhe për të ngritur kisha në mesin e tyre. Kisha në Antioki, ku besimtarët u thirrën për herë të parë të krishterë, u kthye në bazën për dërgimin e misionarëve dhe gjithashtu në bazën e Palit dhe Barnabas. Atëherë kur na drejton Zoti, edhe ne duhet të largohemi nga "Jerusalemi" ynë, me qëllim që të mbjellim kisha në mesin e të humburve dhe të njerëzve të paarritur.

A jeni të gatshëm që ta lini qytetin tuaj me qëllim që të arrini me mesazhin e shpëtimit një qytet apo fshat tjetër? Ju lutem hidhuni një sy hartave të Shqipërisë, që ndodhen në fund të këtij artikulli, për të parë se ku ndodhen kishat ungjillore dhe ku ato nuk ekzistojnë fare. Përqendrimi më i lartë i kishave është në pjesën qendrore të Shqipërisë, duke lënë të paarritura shumë zona në Shqipërinë e Veriut dhe disa zona në jug të Shqipërisë. Ashtu siç e pyeti Zoti Isaian, edhe Fryma vazhdon të na pyesë neve sot: "Kë të dërgoj dhe kush do të shkojë për ne?" (Isaia 6:8). Pyeteni Atë: "Ku dëshiron, o Zot, që unë të shkoj?".

Kishëmbjellja është thelbësore për një rritje të shëndetshme.

Në mënyrë që një lëvizje të lulëzojë, asaj i duhet që të mbjellë kisha. Lëvizja e Asambleve të Perëndisë në Shqipëri vuri një objektiv goxha të guximshëm në vitin 2012, për t'i dyfishuar besimtarët në bashkësitë tona brenda pesë viteve. Me hirin e Perëndisë, ne e arritëm këtë objektiv në vitin 2017, dhe shumica e rritjes dhe e besimtarëve të rinj erdhën përmes kishëmbjelljeve. A dëshironi që të arrini më shumë të humbur? Mbillni një kishë të re! Nga pikëpamja statistikore, në qoftë se një kishë në Amerikë dëshiron që thjesht të mbajë të qëndrueshëm nivelin e anëtarësimit të vet, i duhet të rritet me të paktën 3% për të kompensuar reduktimin e natyrshëm të bashkësisë së saj. Kjo përqindje në Shqipëri do të ishte më e lartë për shkak të çështjeve më të mëdha të emigrimit dhe

lëvizjes së popullsisë. Prandaj, në kontekstin tonë, na duhet të punojmë edhe më shumë dhe të fitojmë më shumë njerëz çdo vit thjesht për të mbajtur nivelet tona aktuale. Në rast se një kishë në Shqipëri dëshiron që të lulëzojë, atëherë i duhet të rritet me të paktën 7 për qind mbi nivelin, sado qoftë ai, gjë e cila nevojitet për të mbajtur shifrat e njëjta që kemi aktualisht.

Në qoftë se jemi të përkushtuar ndaj Porosisë së Madhe, ndaj rritjes së shëndetshme të kishës dhe ndaj të ardhmes së lëvizjes sonë, atëherë duhet ta mbështesim këtë përkushtim duke mbjellë kisha. Një kishë e shëndetshme është ajo kishë e cila rritet dhe e shumëfishon vetveten. A po rritet kisha juaj dhe a po "sjell në jetë" kisha të tjera? Fillojeni thjesht me një!

Kishëmbjellja është përfitim për kishën mbjellëse.

Jeff Farmer e shkroi tezën e tij të doktoraturës rreth mënyrës se si kishëmbjellja ndikon tek kishat mëmë. Ai studioi shtatëdhjetë e pesë kisha të madhësive të ndryshme, të cilat ishin duke kryer kishëmbjellje, dhe i krahasoi ato me shtatëdhjetë e pesë kisha që nuk mbillnin kisha. Duke i krahasuar mes tyre kishat e madhësive dhe prejardhjeve të ngjashme, ai zbuloi se kishat që kryenin kishëmbjellje ishin më të shëndetshme sesa ato që nuk kryenin kishëmbjellje. Në mesin e këtyre kishave kishte më shumë besim, pasion, angazhim në shërbesa dhe entuziazëm. Gjithashtu kishte më pak ndasi dhe grindje midis anëtarëve, për shkak se energjia ishte e fokusuar jashtë kishës. Unë vetë e kam parë këtë realitet në zona si Durrësi dhe Instituti i Kamzës, ku kishat tona kanë një përkushtim të fortë ndaj kishëmbjelljes dhe janë bekuar.

Kur njerëzit dëgjojnë histori për jetë të ndryshuara në kishat e reja, ata fillojnë ta shohin ndryshe komunitetin e tyre. Dhe kështu, pyesin: "Ndoshta mund të ndodhë edhe këtu?". Batica në rritje e kishëmbjelljes i merr përpara dhe i ngre edhe kishat mëmë.

Kishëmbjellja është thelbësore për një rritje të shëndetshme.

Në rast se duam që të arrijmë Shqipërinë dhe Ballkanin për ungjillin, do të na nevojiten mijëra kisha të reja. Për shembull, me qëllim që të arrijmë 10 për qind të popullsisë prej 3 milion banorësh të



Shqipërisë, do të na duhen tre mijë kisha me nga 100 anëtarë. Aktualisht kemi rreth 200 kisha ungjillore. Na kanë ngelur edhe dy mijë e tetëqind! Edhe sa kisha të tjera nevojiten për të fituar 10 për qind të qytetit tuaj? Që ne të arrijmë të gjitha zonat me larmi kulturore në Ballkan, do të na duhen shumë lloje të ndryshme kishash, përfshi këtu edhe ato kisha që janë duke arritur pakicat minoritare.

Mali i Zi mbetet ende vendi më pak i arritur në Evropë, ku numërohen vetëm rreth 150 besimtarë dhe më pak se 10 kisha. Kosova, Maqedonia dhe Turqia kanë nevojë për qindra punëtorë të rinj, për një lëvizje të Frymës së Shenjtë dhe për mijëra kisha të reja. Përgjatë javës së misionit të KTU-së, në prill, ne do zhvillojmë ungjillëzimin e parë në Bosnjë, i cili është një vend i shkatërruar nga lufta e fillim-viteve '90, dhe aktualisht numëron vetëm rreth 12 kisha ungjillore dhe 500 besimtarë. Kisha e Shqipërisë ka arritur tashmë një nivel pjekurie dhe aftësinë për të ndikuar fuqimisht në kombet përreth. Perëndia po na thërret drejt një sakrifice dhe besimi më të madh. Le t'i lutemi Zotit që të thërrasë punëtorë shqiptarë drejt këtyre kombeve të Ballkanit për të mbjellë kisha që shumëfishohen!

Kishëmbjellja është si lindja e fëmijëve - e dhimbshme, por shpërblyese.

Sara, vajza ime, po studion për t'u bërë një "dula", që do të thotë se ajo do të jetë një shoqëruese e barrëlindjes, e cila mbështet nënat që lindin, nga ana fizike, mendore dhe emocionale gjatë dhimbjeve të lindjes dhe momentit të lindjes. Ajo vazhdimisht ndan me ne histori nga lindjet e fëmijëve. Kohët e fundit, ajo pati mundësinë që të priste kordonit e kërthizës së një foshnjeje. Përmes kësaj shërbese, ajo është në gjendje që të jetë dëshmitare e dhimbjeve të lindjes dhe e gëzimit të një jete të re. Në rast se jeni prind, jam i sigurt që e kuptoni për çfarë po flas, sidomos nëse jeni nëna. ☺

Ashtu si lindja fizike, mbjellja e një kishe të re është e dhimbshme dhe e mundimshme. Ju duhet të duroni goxha dhimbje përpara se të "sillni në jetë" me sukses, një kishë të shëndetshme. Por rezultati përfundimtar është një trup i Krishtit që lulëzon, ku ungjilli predikohet dhe njerëzit shpëtohen, shërohen dhe çlirohen për lavdinë e Perëndisë.

Unë sapo dhashë pesë arsye se përse kishat e themeluara duhet të mbjellin kisha. Por, do të ketë gjithmonë "arsye" të shumta pse nuk duhet të mbjellin kisha. Si p.sh. "Jemi kishë e vogël", "Nuk

kemi para mjaftueshëm", "Nuk kemi punëtorë mjaftueshëm".

Një anketim jozyrtar, i para disa viteve, iu kërkonte pastorëve që të përgjigjeshin se sa e madhe duhej të ishte kisha e tyre me qëllim që ata të mbillnin një kishë tjetër. Nga të gjithë, pavarësisht nëse kisha ishte e madhe apo e vogël, shumica e pastorëve u përgjigjën se kur kisha e tyre të rritej me 25 për qind, atëherë do të ishte gati për të mbjellë një kishë tjetër.

Koha ideale mund të duket se nuk vjen kurrë, dhe gjithmonë do të ketë të përfshira dhimbje, besim dhe sakrificë. Mos harroni që nuk jeni vetëm. Zoti është me ju. Me ndihmën e Zotit, ka mjaftueshëm kohë, para, energji dhe hapësira për t'ia dalë. Lindja e fëmijës është e vështirë, por në fund, një foshnjë e bukur ka ardhur në jetë, dhimbjet janë harruar dhe shpeshherë, brenda disa viteve, duam që të kemi një fëmijë tjetër. E njëjta gjë është edhe me kishëmbjelljen.

Në qoftë se jeni pastor i një kishe të themeluar, ju nxis që të merrni një hap besimi. Jini të gatshëm që, së bashku me drejtimin e Frymës së Shenjtë, të investoni një pjesë të kohës, energjisë, njerëzve dhe burimeve tuaja në mbjelljen e një kishe në një zonë ku nuk ka asnjë të tillë. Në rast se jeni një kishëmbjellës, Zoti ju dhëntë forcë dhe ju fuqizoftë për ta transmetuar ADN-në e kishëmbjelljes në kishën tuaj, në mënyrë që një ditë, ajo do të shumëfishojë vetveten.

Perëndisë i pëlqen të bëjë mrekulli. Pozicionojeni kishën tuaj që Ai të mund t'ju përdorë për të transformuar komunitete të reja përmes shumëfishimit të kishtës me anë të fuqizimit të Frymës. Ndërsa shoh drejt të ardhmes, me besimin tek Perëndia, shoh nga një kishë në çdo qytet, fshat dhe lagje. Unë besoj se mund të ndodhë. Po ju?

*Artikulli i mësipërm u përshtat nga një artikull i Ed Stetzer në revistën "Christianity Today", 11 qershor, 2014.



KURT PLAGENHOEF, ka qenë duke shërbyer si një misionar i Asambleve të Perëndisë në Shqipëri prej 20 vitesh...

Shpërndarja e Kishave në Shqipëri



Shtrirja e APSh në Shqipëri





Gratë në Shërbesë NJË KOMUNITET I THIRRUR

Nga: **JUDY RACHELS**

Këtë vit unë u vajosa si shërbenjëse. Ngjarja me rastin e vajosjes sime ishte e mbushur plot me sfida, domethënie dhe simbolizma. Mua më dhanë një mantel, një shkop dhe një Bibël, që janë simbole të shërbesës prej shërbëtori.

Kur erdhi koha për të më
vendosur duart sipër në lutje,
Skoti, djali ynë, i cili, si plak
kishe, më kishte intervistuar, më
kishte dhënë miratimin dhe më
kishte rekomanduar për t'u
vajosur në këtë rol, krijoi një
moment dramatik.

Ai më vendosi përpara një iPad, në të cilin po më tregonte një video nga viti 1992 ku paraqitej nëna ime, Ruth Homer, e cila po citonte këngën e Marisë nga Luka 1 (një nga 25 a më shumë kapitujt të cilët ajo i kishte mësuar përmendësh). Ajo kishte 11 vjet që ishte në qiell me Zotin; e megjithatë, ajo ende më flet.

“Shpirti im e madhëron Zotin, dhe fryma im ngazëllen në Perëndinë, Shpëtimtarin tim, sepse ai e shikoi me pëlqim përlësinë e shërbëtores së tij, sepse ja, tani e tutje të gjithë brezat do të më shpallin të lume, sepse i Pushtetshmi më bëri gjëra të mëdha dhe i Shenjtë është emri i tij! Dhe përdëllimi i tij nga brezi në brez për ata që e druajnë. Ai veproi pushtetshëm me krahun e vet; i shpërndau mendjemëdhenjtë në mendimet e zemrave të tyre; i përmbysi pushtetarët nga fronet e tyre dhe i ngriti të përlurit; i mbushi me të mira të uriturit dhe i ktheu duarbosh të pasurit. Ai e ndihmoi Izraelin, shërbëtorin e vet, duke i kujtuar mëshirën e tij, ashtu si ua pati deklaruar etërve tanë, Abrahamit dhe pasardhësve të tij, përgjithmonë.” (Luka 1:46 – 55).

Nëna ime, në kohën kur ishte shtatzënë me mua, mbolli një kishë, dhe ajo mbolli tek unë sigurinë absolute që Perëndia i përdor gratë për zgjerimin e mbretërisë së Tij. Ajo lulëzonte duke e prezantuar Krishtin përmes zakoneve të padukshme të jetës së saj prej shërbëtoresh, gjithashtu edhe përmes predikimit të saj të fuqishëm.

Edhe pas gjithë atyre viteve, ajo më kujtoi, tani që jam një grua në shërbesë, se Perëndia është i kujdesshëm për shërbëtorët e Tij. Ai është i mëshirshëm ndaj atyre që kanë frikë prej Tij. Ai i ngre të përlurit, i ngop të uriturit dhe i mban premtimet e Tij.

Nëna ime do të dëshironte që, nga kënga e Marisë, unë të mbaja mend se cilësitë aq shumë të nevojshme për të qenë një shërbenjëse efikase janë: një zemër prej shërbëtori, ndërgjegjësimi ndaj Perëndisë, përlësia dhe etja frymërore. Këto janë virtytet e detyruara frymërore për ata që do të shërbejnë dhe do të udhëheqin në emrin e Tij.

Kishat “Asambleja e Perëndisë” janë të përkushtuara për të zhvilluar, për të mentoruar dhe për të furnizuar nga burime të ndryshme shërbenjëset e thirrura e të vajosura, si dhe gratë që po përgatiten për shërbesë.



Ditën e Rrëshajave, apostulli Pjetër, duke cituar profetin Joel 2:28, tha: “Bijtë dhe bijat tuaja do të profetizojnë” (Veprat e Apostujve 2:17).

Jezusi përmbushi, dhe vazhdon të përmbushë, premtimin e Perëndisë për një derdhje të Frymës së Shenjtë në kohët e fundit. Fryma e Shenjtë i thërret dhe i fuqizon si burrat, edhe gratë në kohët e fundit për të ushtruar shërbesën profetike.

Kishat “Asambleja e Perëndisë”, kanë pranuar historikisht se ky lloj fuqizimi nga Fryma iu hap dyert e shërbesës me kredenciale të gjithë aplikantëve të kualifikuar, qofshin ata burra apo gra. Lindja e të ashtuquajturit Calvinizmi i Ri, i cili shpesh jep si mësim se shërbesa me kredenciale është e hapur vetëm për burrat, po bën që shumë djem të rinj (si dhe disa vajza të reja) të tërhiqen nga përkushtimi ynë historik ndaj barazisë në shërbesë.

Sidoqoftë, gjithnjë e më shumë gra janë duke kërkuar kredenciale me kishat “Asambleja e Perëndisë”. Në fakt, në disa zona të vendit tonë (Amerikës), gratë të cilat arrijnë të diplomohen me sukses në degën e teologjisë dhe që kërkojnë kredenciale, janë më të shumta në numër sesa burrat.

Gratë që janë sot në shërbesë, po mbjellin kisha dhe po shërbejnë si kapelane nëpër burgje, spitale, degë të industrisë, madje, edhe në zona ushtarake të luftimit. Ato janë duke e zmbursur errësirën, “të vdekurit që janë gjallë” dhe po përballen me fortesa. Ato janë në qytetin tuaj, në rrethin tuaj, në qarkun tuaj. Ato po i përgjigjen, me krijimtari dhe me guxim, thirrjes për të shërbyer.

Zemra prej shërbëtori, ndërgjegjësimi ndaj Perëndisë, përlësia dhe etja frymërore përbëjnë gjuhën e përbashkët të shërbëtorëve gra që kanë kredenciale me Asamblëtë e Perëndisë. Hidhini sytë përreth, dhe do t’i shihni ato teksa drejojnë kisha, duke shërbyer si pastore ekzekutive, duke drejtuar shërbesa në universitete dhe duke lëvizur drejt vendeve të vështira në mbarë globin. Ato shërbejnë me guxim në stacione misioni të panjohura, ku ngrenë ata që janë të rrëzuar, japin dhembshuri dhe shpesh ndërhyjnë me më tepër butësi në situata të ndryshme. Me besnikëri, ato bëjnë gjithçka që është e mundur, ndërkohë që i besojnë Atij që i thirri për të bërë të pamundurën.



JUDY RACHELS, drejtoreshë e Rrjetit për Gratë në Shërbesë (Network for Women in Ministry), Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë, në Huntington Beach, Kaliforni.

FRYMA E ZOTIT *është* MBI MUA:

Vërtetimi nga Perëndia për shërbesë

Vajosja e Frymës
së Shenjtë mbi një
shërbenjës, sot ka të
njëjtën domethënie, për
shkak se komunikon që
ai ose ajo është zgjedhur
nga një Perëndi sovran
për të qenë në partneritet
me Të, në misionin e Tij,
për të pajtuar botën
me vetveten.

Nga: BETH GRANT



y vajza të reja, të perëndishme e të guximshme, u rritën në varfëri dhe ishin ndër të konvertuarat e para në kishën “Asambleja e Parë e Perëndisë”.

Që të dyja ishin të mbushura me Frymën e Shenjtë dhe ishin thirrur për të shërbyer. Njëra prej tyre shkoi në një kolegji biblik; ndërsa tjetra qëndroi në vendlindjen e saj për të ndihmuar pastorin. Dy vjet më vonë, ato janë përsëri bashkë, duke punuar si një skuadër kishëmbjellëse në qarkun e tyre. Secila prej tyre drejton një takim të përditshëm të një grupi shtëpie, është pastore e një bashkësie, jep mësim pesë herë në javë tek Qendra e Trajnimit Biblik, lutet për të sëmurët dhe dëbon demonët.¹

Këto dy vajza të reja përfaqësojnë kategoritë më të ulëta socio-ekonomike në shoqërinë indiane, pra, janë nga kasta e ulët, janë të varfra dhe janë femra. E megjithatë, Perëndia i ka zgjedhur, i ka vajosur dhe po i përdor për të ndërtuar kishën e Tij në Indi. Fryma e Zotit është mbi to.

Njësoj si paraardhësit e tyre frymërorë dhe historikë, të cilët ishin thirrur dhe fuqizuar me anë të derdhjes fenomenale të Frymës në Indinë e Veriut, një shekull më parë², edhe këto rekrute të kohëve të fundit për punën e Perëndisë në nënkontinentin indian, po kapërcejnë sfida frymërore, kulturore, shoqërore dhe ekonomike për t’iu bindur zërit të Perëndisë. Historia e tyre ilustron një premisë të nënkuptuar, por themelore të shërbesës pentekostale: Vajosja e Frymës së Shenjtë është kredenciali thelbësor dhe përfundimtar për në shërbesë.

Por, përse është vajosja e Frymës së Shenjtë kaq vendimtare në shekullin e 21-të? Në ç’mënyrë është fuqizimi i Tij veçanërisht domethënës për gratë që janë në shërbesë?

Që nga koha që Moisiu vajosi Aaronin dhe bijtë e tij me vaj, si një vepër simbolike të shenjtërimit (Eksodi 30:30; Levitiku 8:12), e deri tek vizita, në formën e një pëllumbi, e Frymës së Shenjtë tek pagëzimi i Jezusit (Mateu 3:16), simbolika dhe realiteti i Frymës së Shenjtë kanë qenë të lidhura me një individ që

veçohet nga Perëndia për në shërbesë. Vajosja e Frymës së Shenjtë mbi një shërbenjës sot ka të njëjtën domethënie sepse komunikon se ai ose ajo është zgjedhur nga një Perëndi sovran për të qenë në partneritet me Të, në misionin e Tij, për të pajtuar botën me vetveten.

Në fillim të shekullit të 21-të, kualifikimet e atyre që mund të njihen zyrtarisht si shërbestarë të ungjillit ndryshon nga njëri vend në tjetrin dhe nga njëri denominacion tek tjetri. Për sa i përket kishave “Asambleja e Perëndisë” në Amerikë, gratë mund të vendosen dhe vajosin në shërbesë. Në disa prej kishave kombëtare të Asambleve të Perëndisë nëpër botë, kjo gjë nuk është e mundur. Ndryshimet e sigjerta të opinionëve brenda trupit të Krishtit dhe interpretimet e ndryshme biblike në lidhje me kredencialet, theksojnë nevojën për ta miratuar vajosjen e Frymës së Shenjtë si shprehinë hyjnore dhe përfundimtare për të vërtetuar shërbesën pentekostale. Vajosja e Frymës së Shenjtë në jetën dhe shërbesën e dikujt është tregues i mbinatyrshëm i thirrjes së paracaktuar nga Perëndia. Kredencialet njerëzore, edhe pse janë të rëndësishme, janë dytësore ndaj ndërgjegjësimit dhe evidencës që: “Fryma e Zotit është mbi mua”.

Vajosja e Frymës së Shenjtë nga Perëndia në shërbesën e një gruaje është një dhuratë e shenjtë dhe e bekuar, një burim sigurimi se ajo është vënë mënjanë prej Tij, për punën e Tij. Kjo ndjesi e thirrjes dhe fuqizimit personal është dokumentuar nga Xhenet Evert Pauërs (Janet Evert Powers³) si një karakteristikë specifike e shërbestareve (femra) pentekostale. Ajo thotë se predikueset e suksesshme pentekostale, tradicionalisht, kanë qenë “shumë më të shqetësuara për të vazhduar që të marrin përvoja të drejtpërdrejta të Frymës, sesa të fitonin pushtet kulturor, për shkak se, pa vajosjen e Frymës, ato nuk do të kishin marrë fuqizim për shërbesën”.⁴ Sipas hulumtimeve të rishqyrtuara nga Pauërs, gratë e angazhuara në shërbesë kanë tendencën për të qenë të vetëdijshme ndaj varësisë që ato kanë të fuqizimi i Frymës së Shenjtë.

Vajosja e Frymës së Shenjtë identifikon ata që Perëndia ka veçuar për të qenë në shërbesë.

Thirrja e Perëndisë për shërbesë në jetën time është një çështje bindjeje, jo një çështje gjinore. Është kuptimi përulës, i mahnitshëm dhe i kthjellët i dorës së Zotit sovran në jetën time. Ai është i vetmi ndaj të cilit jam e përkushtuar të bindem. Bërja e thirrjes së Tij një çështje gjinore do të thotë që të përdhosësh diçka e cila është e shenjtë dhe e çmuar.

E megjithatë, thirrja e Perëndisë për në shërbesë është jetuar dhe shfrytëzuar, në mënyrë të pamohueshme, në kontekstin e dallimeve gjinore brenda kulturës njerëzore. Rolet e burrave në shërbesë shpeshherë përkufizohen në lidhje me pozitën dhe dhuntinë në shërbesë. Këto gjëra kanë tendencën që të përfshijnë, me njëfarë shkalle të konsiderueshme vazhdimësie, etapat e jetës, vendndodhjet gjeografike, pikpamjet denominacionale rajonale, madje, edhe kufijtë kulturorë. Nga ana tjetër, për shumë gra që janë thirrur nga Perëndia, rolet e shërbesës janë më të paqëndrueshme dhe të ndryshueshme. Ato janë dinamike për nga nevoja, dhe vazhdimisht adaptohen dhe ripërkufizohen përgjatë jetës mbi bazën e gjendjes civile, etapave personale të jetës, moshës së fëmijëve, këndvështrimeve denominacionale rajonale, si dhe ndryshoret shoqërore që lidhen me kulturën ku këto gra po shërbejnë. Ndërkohë që një grua përpiket t'i integrojë këta faktorë të jashtëm me thirrjen e një Perëndie sovran në jetën e saj, ajo ndjesia e vazhdueshme, e përulur, e mahnitshme që Fryma e Zotit është mbi të, i jep asaj një dhunti të paçmueshme, pra, një kujtim garantues, të qetë, por të fuqishëm, të perspektivës së tij hyjnore dhe të përjetshme në një botë gjithnjë e më shumë në ndryshim, e cila është e mbushur me perspektiva njerëzore rreth shërbesës dhe roleve. Ai e ka vënë atë mënjanë.

Vajosja e Frymës së Shenjtë në jetën dhe shërbesën e dikujt i tejkalon pengesat tradicionale kulturore dhe hap dyert, që në dukje janë të mbyllura, për shërbesë. Nuk është e pazakontë që fuqia e Frymës së Shenjtë të kapërcejë kategori (të cilat janë të ngulitura mirë) etnike, shoqërore dhe gjinore përmes një shërbëtori të bindur dhe të vajosur të Perëndisë, për të shfaqur dashurinë dhe fuqinë e Jezu Krishtit.



Pastor se ç'kam një përshtypje që nuk na njihni dhe aq mirë..!

Themeluesi i kishës "Asambleja e Perëndisë - Jeta e Re" në Madras të Indisë, pastor D. Mohan, ka sfiduar zemrat dhe mendjet e burrave dhe të grave, që nga kastat më të ulëta dhe deri tek ato më të lartat të qytetit, me predikime të fuqishme e të vajosura të shoqëruara me shenja dhe mrekulli. Megjithëse, historikisht, kastat e larta e të arsimuara të Indisë kanë qenë kundërshtuese ndaj Ungjillit, disa profesionistë të pasur të kastës së lartë vijnë që të dëgjojnë këtë predikues pentekostal, të etnisë tamil, i cili e shqipton Fjalën e Zotit me fuqi dhe pasion të zjarrtë. Këta njerëz nuk tërhiqen vetëm nga fjalët e tij; por tërhiqen nga vajosja e Frymës së Shenjtë që e fuqizon dhe e skalit Fjalën e Zotit në shpirtrat e tyre.

Gotze (Goetz), bashkëshortja e Mohan-it, e cila është një drejtuese e ndërmjetësimit në mesin e grave që prej themelimit të kishës, shërben si një pastore divizioni për drejtuesit e grupeve qelizë të divizionit me rritjen më të shpejtë në këtë kishë prej 15 mijë anëtarësh. Duke qenë një anëtare e një denominacioni në të cilin nuk i shugurojnë gratë, ajo është shembulli i një gruaje të bindur të Perëndisë, me guxim dhe përulësi, shërbesa e të cilës është e miratuar me anë të një vajosjeje të pagabueshme të Frymës së Shenjtë. Ashtu si profetesa Debora, e

Vajosja e Frymës së Shenjtë komunikon përtej kategorive dhe kufijve njerëzorë.

cila e udhëhoqi ushtrinë e Izraelit në beteja me urdhrin e Perëndisë (Gjyqtarët 4), edhe Gotze i udhëheq përditë besimtarët indianë në beteja frymërore përmes lutjes së zjarrtë dhe të guximshme. Ashtu si Debora, edhe Gotze është e ndjeshme ndaj faktit se roli i saj drejtues është i pazakontë për gratë në kulturën e saj. E megjithatë, ashtu si homologia e saj e Dhjatës së Vjetër, kjo nënë indiane me tre fëmijë ka dëgjuar zërin e Zotit, i cili vazhdon të thërrasë gra për betejë. Fryma e Zotit është mbi të.

Bindja e Gotze-s nuk ka qenë pa rrezik për të dhe për bashkëshortin e saj. Rreziku që ajo të ishte e keqkuptuar, si nga ana kulturore, shoqërore dhe denominacionale, ka qenë i madh. Ajo ka qenë e pasigurt nëse duhet të mbante pozicionin e saj tradicional në shërbesë, dhe të përshtatshëm nga ana kulturore, dhe për rrjedhojë të mos duket sikur nuk e nderon bashkëshortin e saj, apo nëse duhet të lëvizte me besim në ato fusha të shërbesës në të cilat kishte marrë dhuntinë nga Fryma e Shenjtë. Pastor Mohan-i dhe bashkëshortja e tij, me kujdes dhe duke u lutur, kanë rënë dakord që ajo duhet të vazhdojë të rritet dhe të ushtrojë shërbesën ku Perëndia e ka shuguruar, pavarësisht rreziqeve. Si rezultat i kësaj, puna për Mbretërinë në qytetin e Madras është shumëfishuar.

Kjo nuk do të thotë se kategoritë kulturore, shoqërore dhe fetare do të ndryshojnë domosdoshmërisht për shkak se një burrë apo një grua pranohet se është i/e vajosur nga Perëndia. Megjithatë, prania e fuqishme e Perëndisë në jetën e një shërbenjësi, qoftë mashkull apo femër, i motivon njerëzit që të gjejnë mënyra krijuese për ta përfshirë shërbesën e tyre në kishë. Në një vend ku kultura e kishës nuk i pranon gratë si predikuese, një grua, të cilën e konsiderojnë se ka një shërbesë të shuguruar prej Perëndisë, mund ta ftojë për të dhënë një dëshmi gjatë takimit të kishës dhe ta inkurajojë privatisht për të marrë sa kohë që të dëshirojë. Në kishat pentekostale nga Italia në Indi, nuk është e pazakontë që gratë e perëndishme të shërbejnë me fuqi dhe në mënyrë të artikuluar përmes dëshmive apo profecive me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë.

Manovrimi kulturor dhe krijues i kategorive, për të përshtatur shërbesat jo-tradicionale, mund të marrë nuanca komike. Para shumë vitesh në Indinë e Jugut, çështja për t'iu dhënë grave kredenciale ishte kthyer në një debat të nxehtë. Gjatë diskutimit, në platformë ishin ulur edhe dy misionare të vjetra amerikane, të cilat kishin shërbyer prej shumë vitesh si predikuese dhe mësuese në atë rajon. Kur iniciativa për t'iu dhënë grave kredenciale u hodh tërësisht poshtë nga këshilli, një nga gratë misionare u habit, për shkak se ajo, bashkëpunëtorja e saj dhe shumë misionare të tjera amerikane ishin pranuar për vite me radhë që të dilnin në foltoret e kishës indiane. Ajo pyeti drejtorin kombëtar se përse ajo bashkë me kolegen e saj ishin mirëpritur me shumë hir për të shërbyer, ndërkohë që nuk kishte ndodhur njësoj me koleget e saj indiane. Drejtori i ktheu një përgjigje të shpejtë e të logjikshme: "Por juve nuk jeni gra; juve jeni misionare". Është e mahnitshme se si i hap Perëndia dyert për në fusha emocionuese dhe ndonjëherë të papritura të shërbesës kur neve nuk jemi të shqetësuar rreth ambalazhit të shërbesës sonë. A është e mundur që ne, si pentekostalë, të jemi duke e humbur thelbin misionar të Perëndisë për vajosjen me Frymën e Shenjtë tek ata që ai thërret?

Vetë Jezusi shpalli se Fryma e Zotit ishte mbi të, duke e vajosur atë që t'u predikonte lajmin e mirë të varfërve, të shpallte liri për ata që ishin në robëri dhe t'u kthente shikimin të verbërve, të çlironte të shtypurit, dhe të shpallte vitin e favorit të Zotit (Luka 4:18, 19). Lidhja që Biri i Perëndisë i bën vajosjes së Frymës së Shenjtë me këto lloj shërbesash është një kujtesë domethënëse se ku duhet të jetë siguria jonë në rast se duam edhe ne që të kemi një ndikim të ngjashëm në botën tonë përmes dashurisë dhe fuqisë transformuese të Jezu Krishtit. Fuqizimi nga ana e Frymës së Shenjtë nuk është me zgjedhje; por, është një përbërës praktik dhe vendimtar për një shërbesë thelbësore.

Ne si pentekostalë, jemi bekuar historikisht duke qenë të ekspozuar ndaj veprës dhe Personit të Frymës së Shenjtë, si në doktrinë, ashtu edhe përvojë. Megjithatë, duke qenë shërbenjës të

*Vajosja e Frymës së Shenjtë është thelbësore
për shërbesën jetëndryshyese në shekullin e 21-të.*

mbushur me Frymën, të cilët përballen me një botë gjithnjë e më shumë të rrënuar nga SIDA, nga familjet e shkatërruara, nga abuzimi seksual, nga pornografia dhe urrejtja etnike, është shumë vendimtare që t'i rikthehemi edhe një herë ditës së Rrëshajave dhe pyetjes së përrjetshme që është aq unike për ne si pentekostalë: "Ç'do të thotë kjo?" (Vep. 2:12). Derdhja e Frymës së Shenjtë, siç lidhet me shërbesën e përditshme, është diçka jetëndryshuese dhe transformuese, ashtu siç e donte edhe Jezusi (Gjoni 14:12). Sigurisht pyetja ka rrjedhoja që shkojnë përtej evidencës fillestare të të folurit në gjuhë të panjohura gjatë mbushjes së parë të Frymës së Shenjtë.

Si e ndikon, dinamika frymërore e përvojës sonë pentekostale, shërbesën tonë të përditshme ndaj burrave, grave dhe fëmijëve që jetojnë me realitetet e zymta të shekullit të 21-të, të ballafaquar me vuajtjen e urisë në Etiopi, me homoseksualët që vdesin nga SIDA në Amerikën Veriore, me intelektualët e verbër nga ana frymërore në Evropën Perëndimore dhe me viktimat e prostitucionit të fëmijëve në Azinë Jugore?

Sot, për ata që punojnë dhe shërbejnë nëpër shërbesa, ka mjaft mjete teknologjike në dispozicion, të cilat janë të komplikuar dhe emocionuese. Megjithatë, është e rëndësishme që të konfirmojmë

rëndësinë dhe prioritetin që ka fuqizimi nga Fryma, autoriteti frymëror dhe varësia jonë tek mënyrat e Tij në vend të mënyrave tona. Modelet kulturore dhe kolektive të udhëheqësisë mund të ofrojnë mprehtësi të mendjes dhe burime të shkëlqyera kur përdoren të ndërthurura me dhuntitë frymërore që Perëndia i ka dhënë Kishës. Por veglat dhe mjetet njerëzore nuk mund të zëvendësojnë fuqinë dinamike çliruese të Frymës së Shenjtë, e cila vepron përmes jetës së një burri apo gruaje të përkushtuar të Perëndisë.

Për fat të keq, sot në kishën perëndimore gjejmë shpeshherë pafuqi dhe parehati në përballjen me skllavërinë frymërore. Kjo është po aq tragjike dhe dekurajuese tani sa ishte kur dishepujt e Jezusit sfiduan, pa qenë të efektshëm, të ligun tek i demonizuari në shekullin e parë (Mateu 17:14-21). Por Luka na thotë se Jezusi u dha dishepujve të tij fuqinë dhe autoritetin mbi të gjithë demonët dhe gjithashtu për të shëruar sëmundjet (Luka 9:1). A po e përvetësojmë fuqizimin e mbinatyrshëm që na ka premtuar Zoti ynë dhe a po shërbejmë me këtë fuqizim?

Pikërisht këtë po bëjnë dy vajzat e perëndishme nga India të cilat i përshkruam në hyrje të këtij artikulli. Ato kanë shumë pak ose aspak pushtet dhe autoritet të përfutur nga kultura e tyre, dhe e kuptojnë fare

Mjetet njerëzore
nuk mund të
zëvendësojnë
fuqinë dinamike
çliruese të Frymës
së Shenjtë, e cila
vepron përmes
jetës së një burri
apo gruaje të
përkushtuar të
Perëndisë.



Na dhëntë Perëndia, neve shërbëtorëve të Tij, një vajosje të re dhe të fuqishme të Frymës së Tij!

SHËNIME

1. Marrë nga buletini i një misionari nga India e Veriut (Mars 2000). Emrat nuk janë shfaqur për shkak të ndjeshmërisë së temës.
2. Gary B. McGee, "Baptism of the Holy Ghost & Fire!: The Revival Legacy of Minnie F. Abrams of India" (Pagëzimi në Frymën e Shenjtë dhe me Zjarr!: Trashëgimia Rizgjuese e Mini F. Abrams-it në Indi) në revistën *Enrichment (Thesare)* (Verë 1998): 80 - 87.
3. Janet Evert Powers, "'Your Daughters Shall Prophesy': Pentecostal Hermeneutics and the Empowerment of Women" (Bijat Tuaja do të Profetizojnë: Hermeneutika Pentekostale dhe Fuqizimi i Grave) në librin *The Globalization of Pentecostalism: A Religion Made To Travel*, (Globalizimi i Pentekostalizmit: Një Besim i Bërë për të Udhëtuar) ed. Murray W. Dempster, Byron D. Klaus, Douglas Petersen (Oxford, UK: Regnum Books International, 1999), 319, 320.
4. Po aty, 331.
5. Harvey Cox, *Fire From Heaven: The Rise of Pentecostal Spirituality and the Reshaping of Religion in the Twenty-first Century*. (Zjarr nga Qielli: Ngritja e Anës Frymërore Pentekostale dhe Formësimi i Besimit në Shekullin e 21-të) (Reading, Mass: Addison-Wesley Publishing Co., 1995), 198, 199.



BETH GRANT, Ph.D. ka shërbyer si një misionare e Asambleve të Perëndisë në Azinë Jugore për 23 vjet.

mirë pafuqinë e tyre shoqërore dhe ekonomike. Por duke u bërë pjesë e familjes së Perëndisë dhe duke rënë në kontakt me përvojën e pagëzimit në Frymën e Shenjtë, ato kanë zbuluar dhe kanë përqaftuar fuqinë e ditës së Rrëshajave dhe janë duke e sfiduar me siguri dhe besim errësirën përreth tyre. Së bashku me burra dhe gra të tjerë të Perëndisë, të shekullit të 21-të, ato janë kthyer në bartëse të autoritetit të vërtetë frymëror, të bazuar në solidarizimin e tyre aktiv me autoritetin frymëror të Mjeshtrit të tyre (Mateu 28:18-20). Shërbimi i tyre i vajosur dëshmon për fuqinë e Tij; po ndërton kishën e Tij dhe po sjell një dëshmi të dukshme të lavdisë së Tij në kombin e tyre nevojtar.

PËRMBYLLJA

Përgjatë mijëvjeçarit e deri në shekullin e 21-të, burra dhe gra që përfaqësojnë kombet e botës, të pasurit dhe të varfrit, të arsimuarit dhe të paarsimuarit, kanë njohur në thellësi të zemrave të tyre, që ashtu si tek Jezusi, Fryma e Zotit ishte mbi ta. Në sytë e shoqërisë, ata shpeshherë kanë qenë njerëz të cilët mund të anashkaloheshin lehtësisht, pra, dukeshin pa pretendime, të zakonshëm dhe të përlulur, derisa fillonin të flisnin, luteshin, këndonin, shkruanin dhe të jepnin mësim. Qoftë në kishë, në treg, në salla koncerti apo në klasa, vajosja e Frymës së Shenjtë kërkon një përgjigje dhe i vendos mënjanë burrat dhe gratë e Perëndisë.

JEZUSI DHE GRATË

Në ç'këndvështrim i shihte Jezusi gratë? Si i trajtonte ai ato? Si reagonin ato ndaj Tij?

Ungjilli sipas Lukës na ofron përgjigjet për këto pyetje. Tek Luka, e hasim Jezusin 24 herë ku ose takon një grua, ose flet me një grua ose e përmend një grua në shëmbëlltyrat e tij.

Të gjitha këto 24 raste janë edukative dhe pozitive. Fjalët “pranues”, “i ndjeshëm” dhe “konfirmues” përmbledhin atë që na japin si mësim, qoftë ajo që shkruan Luka, qoftë shembulli i vetë Jezu Krishtit, në lidhje me Jezusin dhe me gratë.

JEZUSI ISHTE PRANUES

Jezusi i pranoi dhuratat e butësisë dhe të shërbimit me dashuri, të cilat ia ofruan Atij gratë. Libri i Lukës është një libër i pazakontë për literaturën e botës së lashtë. Luka u kujdes jashtë mase që të shkruante rreth reagimeve emocionale dhe fizike të një gruaje gjatë shtatzënisë së saj. Luka na informon në mënyrë të hollësishme rreth takimit të parë të Elizabetës me Marinë, e cila ishte shtatzënë me Jezusin. Luka thotë: “Fëmija i kërceu në bark” (Luka 1:41). Maria, duke reaguar ndaj komenteve të Elizabetës, shpalli: “Shpirti im e madhëron Zotin, dhe fryma im ngazëllen në Perëndinë, Shpëtimtarin tim” (vargjet 46, 47). Luka gjithashtu raporton rreth butësisë së Marisë, kur ajo e mbështolli Jezusin e sapolindur me pelena dhe e shtriu atë në një grazhd.

NGA DOUG CLARK

U

në nuk di ndonjë libër tjetër në historinë e lashtë që të jetë interesuar dhe të jetë kujdesur për ndjenjat e një gruaje ndërkohë që ajo mban fëmijën e saj në bark apo në kohën kur kujdeset për fëmijën e vet. Por Perëndia mendoi se këto gjëra ishin aq të rëndësishme, sa duhej t'i përfshinte ato në Fjalën e Tij të përjetshme.

Kuptimi që Jezusi kishte për burrërinë, nuk u kërcënua asnjëherë nga butësia e një gruaje. Luka tregon për një grua që erdhi në një gosti, u ul në gjunjë, qau tek këmbët e Jezusit, duke i larë ato me lotët e saj, dhe pastaj i vajosi ato me parfum përpara se t'i thante me flokët e saj (Luka 7:36-50). Kjo ishte vepra e saj e pendimit. Jezusi e lejoi atë të bënte atë që bëri, pa pasur qoftë edhe një gjurmë neverie apo turpërimi.

Asnjë rabin në kohën e Jezusit, me aq sa di unë, nuk i ka përfshirë gratë në mesin e dishepujve të tij. Por Luka thotë se Jezusi i përfshiu gratë në rrethin e ndjekësve të tij, madje edhe gra me historik të dyshimtë.

Gratë i shërbyen Jezusit në mënyra unike. Shtëpia e Marisë dhe e Martës ishte një vend i qetë ku Jezusi tërhoqej herë pas here për t'u larguar nga turmat që dëshironin të merrnin bukë, të shihnin mrekulli dhe të përjetonin shërime (Luka 10:38-42).

Luka shkroi për turmën që e vuri Jezusin përpara dhe e shtyu drejt Golgotës. "Bijat e Jerusalemit" e ndoqën dhe vajtuan për Të, ndërkohë që edhe ato përshkuan Via Dolorosa-n ("Rrugën e Dhimbjeve"; Luka 23:27-29).

Çfarë ndodhi në momentin e kryqëzimit? Dishepujt u arratisën, përfshirë këtu edhe Pjetrin, atë që tha: "Nuk do të të braktis kurrë; nuk do të ta kthej asnjëherë kurrizin; jam gati të shkoj bashkë me ty edhe në vdekje" (Luka 22:31-34).¹ Por gratë qëndruan, në heshtje, duke bërë roje tek këmbët e kryqit. E çfarë tjetër mund të bënin? Absolutisht asgjë, përveçse të ishin aty.

Jeta nuk ka ndryshuar. Shumë njerëz ndihen sikur janë mbi një kryq; mbi një kryq të lëngatave, të sëmundjeve mendore dhe të vështirësive fizike, emocionale apo financiare. Ndonjëherë gjëja më e mirë që mund të bëni, është që të jeni të pranishëm. Gratë ishin të pranishme për Jezusin në atë çast, e deri sa vdekja e çliroi.



Madje, edhe pas vdekjes së Jezusit, ndërkohë që dishepujt qëndronin të fshehur pas dyerve të mbyllura, të frikësuar se mos romakët i gjenin dhe i çonin në kryq, ishin gratë ato që përgatitën vajrat me aroma që ta vajosnin trupin e Tij, për një varrim siç i kishte hije. Këto gra i çuan vajrat erëkëndshëm tek varri, duke mos pasur asnjë ide se si do ta lëviznin gurin. Gjithsesi, ato shkuan në orët e para të mëngjesit, ndërkohë që ishte ende errët, për të bërë atë që kishin mundësi.

Gratë i shërbyen Jezusit që prej çastit kur Biri i Perëndisë u shfaq në botën tonë, në formën e një foshnjeje të vockël e të pambrojtur, e deri në orët e fundit, përpara Ngjitjes së Tij në qiell. Dhe Jezusi i pranoi këto dhurata dashurie, por jo për shkak se ato ishin privilegjet e Tij si njeri, të dhëna prej Perëndisë. Përkundrazi, ai i pranoi ato, sepse ishin dhurata të shërbimit të mirëmenduar dhe besnik ndaj Atit qiellor.

JEZUSI ISHTE I NDJESHËM

Jezusi ishte i ndjeshëm ndaj disavantazheve shoqërore dhe fetare me të cilat gratë duhej të përballeshin, dhe ai ua hoqi ato barra. Ai ishte i dhembshur dhe i dashur.

Një ditë, Jezusi i bëri një vizitë Pjetrit në shtëpinë e tij, mirëpo vjehrra e tij ishte e sëmurë. Në Lindjen e Mesme, edhe në rast se gruaja e shtëpisë është e sëmurë, ajo çohet për t'i shërbyer mysafirit. Por sigurisht, Jezusi nuk ishte një mysafir i zakonshëm. Ai ishte një rabin, një mësues i ligjit të Perëndisë. Ai kishte të drejtën që të hynte në shtëpi, të ulej dhe të pyeste: "Ku e kam çajin?". Por Jezusi nuk e bëri këtë. Ai refuzoi të ushtronte privilegjin e tij si mysafir. Përkundrazi, ai shkoi së pari tek vjehrra e Pjetrit dhe vuri duart e Tij mbi të. Ai refuzoi ta lejonte atë që t'i shërbente Atij pa i shërbyer më parë Ai asaj.

Një herë tjetër, Jezusi ringjalli nga vdekja djalë e një vejushë në Nain (Luka 7:11-17). Pozita e të vejave në kulturën e Lindjes së Mesme është tragjike, në qoftë se ato nuk kanë asnjë të afërm mashkull që të kujdeset për to. Ndërkohë që Jezusi shihte vargun e njerëzve që dilnin nga qyteti për të shkuar tek varrezat, ai vuri re që ishin disa persona të cilët po mbartnin një arkivol dhe një grua të vetme që ecte pas arkëmortit. Kështu, ai kuptoi se kjo grua nuk kishte asnjë të afërm tjetër mashkull që të kujdesej për të. Dhe nga dhembshuria për këtë vejushë të gjorë, Jezusi u afrua, e preku të riun dhe e risolli atë në jetë.

Por, në mënyrë edhe më të fuqishme, tek Ungjilli i Lukës shohim Jezusin që e kundërshton paragjykimin dhe keqpërdorimin e fesë së organizuar kundër grave. Në atë pjesë të botës, vepra të tilla mund të jenë të rrezikshme. Tek Luka 20, Jezusi i mbrojti vejushat nga lakmia e farisenjve.

Por ndoshta shembulli më i madh dhe më i bukur gjendet tek Luka 13, ku gjatë shabatit, në sinagogën e Kapernaumit, Jezusi shëroi një grua. Sinagoga në Kapernaum ishte rreth 20 metra e gjerë dhe 40 metra e gjatë, dhe ashtu si xhamia, ishte një vend për burrat. Dhe gjatë shabatit, pritej që ajo të ishte e mbushur plot e përplot me burra, sepse atje ndodhej Jezusi, Mësuesi (Luka 13:10-17), i cili do të shpjegonte Fjalën e Perëndisë. Të gjithë prisnin të dëgjonin gjëra të mëdha, të cilat do të sillnin një kthesë rrënjësore, nga ky autoritet i ri i shkëlqyer i Ligjit. Por ndërkohë që Jezusi mori dorëshkrimin e Ligjit dhe filloi të jepte mësim, papritur, aty nga fundi i dhomës, ai vuri re një grua e cila ishte e kërrusur. Për vite të tëra, ajo kishte qenë e burgosura e një fryme të ligë që e kishte lidhur dhe e kishte mbajtur të gjymtuar.

Atëherë Jezusi bëri pesë gjëra që janë të mahnitshme, sepse ajo që ai bëri, theu kallëpin kulturor të kohës. Së pari, ai e thirri gruan që të dilte nga vendi i saj (pjesa e pasme e sallës) dhe të qëndronte në vendin e burrave (në pjesën e përparme të sallës). Ai ndërpreu mësimdhënien nga Fjala e Perëndisë, që ishte koha më e shenjtë në

jetën e hebrenjve, për t'i shërbyer një gruaje.

Së dyti, Jezusi shkeli kulturën duke i folur asaj gruaje. Autori hebre, Alfred Eidersheim, ka shkruar se ekzistonin disa mësues të ligjit të cilët luteshin çdo ditë: "Të falënderoj, o Perëndi, që nuk u lindi një johebre, një qen apo një grua". A nuk është kjo një lutje poshtëruese? (A e vini re rendin e fjalëve?). Nuk është çudi që të gjithë u tronditën kur Jezusi i foli kësaj gruaje.

Jezusi e shkeli kulturën për të tretën herë: Ai vuri duart mbi të. Eidersheim shpjegon se, në kohën e Jezusit disa farisenj quheshin "farisenjtë zi e blu". Pse? Sepse ata ishin aq të rreptë, për sa i përket respektimit të Ligjit, saqë as nuk ia hidhnin sytë një gruaje. Në rast se do të ndjenin se një grua do të shkëmbehej në rrugë me ta, ata do t'i mbyllnin fort sytë dhe do të ecnin drejt. Ndonjëherë do të përplaseshin me ndonjë mur ose do të binin mbi ndonjë qerre qesh dhe kështu përfundonin me të nxira nëpër trup (prej nga e morën edhe emrin). Këtu, në kontrast me shembullin e "farisenjve zi e blu", Jezusi vuri duart e tij mbi një grua.

Së katërti, Jezusi e konfirmoi vlerën e saj në shoqëri. Ata burra që ishin në sinagogë me shumë mundësi po mendonin: "Çfarë do ajo këtu? Po Ai, çfarë po bën? Po e prek. Shikoni se ç'po bën ai në vendin e shenjtë të Perëndisë".

Jezusi i njihte zemrat e tyre dhe iu tha: "A nuk e zgjidh secili prej jush në shabat nga grazhdi kaun e vet, ose gomarin dhe ta çojë për të pirë?" (Luka 13:15). Ata të gjithë e dinin se e kishin thyer shabatin duke i çuar kafshët e tyre për të pirë ujë.

Dhe Jezusi vazhdoi: "Kjo grua ka më shumë vlerë sesa kafshët që ju keni në shtëpi. Kjo grua nuk është një kafshë; ajo është 'bijë e Abrahamit'" (Luka 13:16). Duke thënë kështu, Jezusi e restauroi atë në pozitën që i takonte.²

Ky episod është veçanërisht i rëndësishëm për shkak se Jezusi e rrezikoi me gatishmëri jetën e tij për hatër të një gruaje. Ai i turpëroi kundërshtarët e tij në sinagogën e tyre duke i shërbyer një gruaje me ndjeshmëri, mirësi dhe mëshirë. Pikërisht për këtë vepër mirësie dhe për këtë dashuri hyjnore, si dhe për shumë vepra të tjera si këto, këta burra e dërguan atë në kryq.

JEZUSI ISHTE KONFIRMUES

Jezusi ua bëri të ditur grave se ato ishin inteligjente dhe se, në thelb, ato ishin të denja për dashurinë dhe kujdesin e Perëndisë. Në asnjë rast, në të katërt





ungjijtë, Jezusi nuk uli poshtë ndonjë grua. Sa do të doja të thosha se unë nuk kam thënë kurrë një barsoletë që tallet me gratë, që nuk e kam parë kurrë një grua në një mënyrë të papërshtatshme apo që kurrë nuk i kam thënë një gruajë: “Këto janë gjëra burrash. Ti shih punën tënde!”. Shumica e burrave, në një moment gjatë jetës së tyre, e kanë trajtuar një grua me mospërfillje. Por Jezusi nuk e bëri asnjëherë këtë. Që ditët e para të jetës së tij, deri në kohën kur u ngjit në qiell, Jezusi i lartësoi dhe i konfirmoi gratë.

Tek Luka 1 dhe 2, shkrimtari ka regjistruar lindjen dhe ditët e para të jetës së Jezusit. Në kulturën pakistaneze dhe afgane (por edhe në Lindjen e Mesme), kur lind një djalë, burrat mbledhen rreth e rrotull babait. Nëna e foshnjës bëri të gjithë punën e vështirë, por burrat i rrahin shpatullat babait dhe thonë: “Marshalla! Bekuar qoftë Perëndia! Ia dole! ‘Aslanim’, luani im”.

Por çfarë ndodh në qoftë se fëmija është vajzë? Gratë mbledhen rreth nënës dhe i thonë: “E gjora ti! Urojmë që të kesh më shumë fat herën tjetër!”. Tradita në një pjesë të mirë të botës thotë se djali është produkti i natyrshëm i fuqisë së babait të tij, ndërsa vajza është gabimi i nënës së saj. E megjithatë, në historinë e lindjes së Jezusit dhe ditëve të para të tij, ishte Maria ajo që mori një vlerësim të barabartë me Jozefin, në mos më shumë se ai. Jozefi pothuajse u venit në sfond. Ishte Maria ajo që zuri vendin në qendër të skenës së kësaj drame të mrekullueshme.

Gjatë dedikimit të Jezusit në tempull, ishte profeteshja Ana, ajo që zuri qendrën e skenës (Luka 2:36-38). Fjala e Perëndisë ia njeh asaj jetën e perëndishme dhe agjërimin dhe lutjen e saj.

Për ditëlindjen e 12-të të Jezusit, Maria dhe Jozefi e çuan Atë në tempullin e Jerusalemit (Luka 2:41-52). Kjo ishte ceremonia “bar mitzvah” e Jezusit, pra, ai do të bëhej biri i Besëlidhjes, në të cilën, sipas ligjit hebre, ai ishte tashmë një burrë. Ai tani nuk ishte i detyruar që t’i vinte veshin ndonjë gruajë për gjithë jetën e vet. Por, ndërsa Jozefi dhe Maria u kthyen në shtëpi, ata vunë re se Jezusi nuk ishte me pjesën tjetër të familjes. Kështu që, u kthyen me nxitim në Jerusalemin dhe e gjetën Jezusin në tempull. Ai ishte duke këmbyer pyetje me mësuesit e Ligjit, në formën e debatit, gjë që ishte e zakonshme asokohe. Maria i tha Jezusit: “Ku ishe? Na frikësove kur nuk po të gjenim dot” (vargu 48).

Jezusi (që tani ishte një bir i Besëlidhjes, një burrë) fare lehtë mund të kthehej nga e ëma dhe t’i thoshte: “Grua, lërmë rehat”. Përkundrazi, ai iu drejtua me shumë dashuri dhe respekt: “A nuk e dinit se më

duhet të merrem me punët e Atit tim?” (vargu 49).

Shpeshherë, Jezusi devijonte nga planet e Tij për t’i lavdëruar gratë si shembuj të besimit. Ai shkoi në shtëpinë e Simonit, që ishte një farise (Luka 7:36-50). Në qendër të shtëpisë kishte tavolina, dhe rreth tavolinave kishte divane. Njerëzit e rëndësishëm të qytetit, të cilët ishin të ftuarit e veçantë të Simonit, ishin shtrirë mbi këta divane duke ngrënë nga tavolinat. Por, në tavolinë, ishte dikush i cili nuk po hante: Mësuesi, i ftuari i nderit. Ai nuk ishte larë; duart dhe këmbët i kishte ende të papastrat. Në rast se do ta prekte tavolinën, ai do ta bënte atë të papastër për të gjithë të tjerët.

Koha kalonte, njerëzit vazhdonin të hanin. Papritur, në gosti, vjen një grua e rrugëve. Ajo u përgjunj, qau sipër këmbëve të Jezusit, pastaj i lëshoi flokët dhe me to ia thau këmbët Atij. Dhe në fund, ajo hodhi parfum erëmirë mbi këmbët e Jezusit. Kjo ishte një skenë tronditëse. Të gjithë burrat në tavolinë e dinin se ç’lloj gruajë ishte ajo. Të gjithë e kishin parë këtë shfaqje të shpifur dhe prisnin të shihnin se ç’do të bënte Jezusi për t’i treguar asaj gruajë se sa i shenjtë ishte ai. Simoni mendoi: “Shih si e prek kjo grua Jezusin dhe si sillet në praninë e këtyre burrave të mirë. Ne e ftuam këtu këtë mësues për ta parë me sytë tanë nëse ai është me të vërtetë mësues nga Perëndia. Tani e dimë me siguri që Ai është një mashtrues. Po të kishte qenë nga Perëndia, do ta dinte se ç’grua është ajo. Nuk do ta lejonte kurrë që ajo të bënte gjërat që bëri” (vargu 39).

Nga pikëpamja e Lindjes së Mesme, kjo skenë është absolutisht e pabesueshme. Dy gjëra nuk shkojnë siç duhet këtu. Së pari, i zoti i shtëpisë, Simoni, e kishte ofenduar me paramendim mysafirin e tij. Ai e kishte lënë qëllimisht Jezusin, të ftuarin e nderit, në një gjendje të palarë, për ta turpëruar atë dhe për të treguar epërsinë që Simoni dhe miqtë e tij mendonin se kishin mbi Jezusin. Të zotët e shtëpisë në Lindjen e Mesme nuk i ofendojnë kurrë mysafirët. Ata nxjerrin gjërat më të mira që kanë, për t’i ndarë me mysafirët e tyre, madje edhe në rast se kanë vetëm



bukë edhe ujë, madje edhe në qoftë se kjo gjë i lë ata pa asnjë kacidhe.

Në një rast, unë dhe bashkëshortja ime vizituam një shtëpi në Bejrut të Libanit. Ishim me disa miqtë tanë, dhe gruaja e shtëpisë po i tregonte bashkëshortes sime disa qëndisma me dantella të cilat ajo i kishte qëndisur për tavolinën. Unë thashë: “Oh, sa të mira! Qenkan shumë të bukura!”.

Sapo fjalët kishin dalë nga goja ime, e dija që kisha thënë gjënë e gabuar. Kur u larguam nga shtëpia e tyre atë natë, zonja e shtëpisë ishte aty, duke mbajtur në duar një pako të vogël të cilën ia dha bashkëshortes sime, dhe brenda në të ishin disa nga ato qëndisimat e bukura që kisha lavdëruar. Unë isha një mysafir, dhe ajo dëshironte të më nderonte. Kurdoherë që i shoh ato, ndjej një lloj ndrojtjeje dhe turpi, sepse bëra diçka që një mysafir nga Lindja e Mesme nuk do ta kishte bërë kurrë.

Simoni kishte bërë atë që asnjë zot shtëpie nga Lindja e Mesme nuk do të kishte bërë ndonjëherë. Por në këtë pasazh shohim se Jezusi bëri diçka që asnjë mysafir nga Lindja e Mesme nuk e kishte bërë kurrë: ai kritikoi të zotin e shtëpisë. Jezusi u çua në këmbë, vështroi gruan, dhe i foli Simonit. Jezusi i ktheu shpinën të zotit të shtëpisë përpara gjithë burrave që ishin në gosti.

Duke e parë gruan me dhembshuri, Jezusi e qortoi Simonin, duke i thënë: “Që nga çasti kur kam shkëlur

në shtëpinë tënde, ti më ke trajtuar me përbuzje. Ti as nuk dërgove një shërbëtor që të më lante duart dhe këmbët e as nuk më dhe ujë që t'i laja vetë duart dhe këmbët. Ndërsa kjo grua nuk ka reshtur së lari këmbët e mia me lotët e saj që nga momenti kur hyri në dhomë. Ajo ka bërë atë që duhej të bëje ti, dhe tani ajo - jo ti - do të largohet e drejtësuar” (Luka 7:44-50).

Luka 10 na tregon për Jezusin që shkon tek shtëpia e Marisë dhe e Martës për të pushuar. Marta ishte në lëvizje nëpër shtëpi, si një grua tipike nga Lindja e Mesme. Për Jezusin, ajo donte që ta shtronte tryezën në mënyrën më të mirë. Dhe duke qenë se u lodh nga puna, ajo u zemërua me Marinë, motrën e saj, e cila ishte e ulur dhe po dëgjonte Jezusin. Dhe mesazhi i Jezusit për Martën ishte: “Eja dhe ulu pak.

Pjesa më e rëndësishme e jetës tënde nuk është në kuzhinë. Perëndia nuk të krijoi thjesht që të shtrosh e të ngresh tavolinën. Skribët dhe farisenjtë nuk janë të vetmit që kanë të drejtën ta njohin Fjalën e Perëndisë. Edhe ti, Marta, edhe çdo grua tjetër si ty, ka po aq të drejtë sa ata” (vargjet 41, 42).

Jezusi tregoi disa herë shëmbëlltyra rreth grave dhe gjithmonë i lartësoi pozitat e tyre. Luka 15 tregon shëmbëlltyrën e gruas që humbi monedhën. Ç'lloj gruaje ishte ajo? A ishte ndonjë grua budallaqe që nuk dinte se ku i kishte paratë e veta? Jo. Ajo ishte gruaja e shkathët dhe inteligjente, e cila ndezi llambat.

Shtëpitë në Lindjen e Mesme, në kohën e Jezusit, i kishin dritaret shumë afër tavanit, për ta mbajtur ambientin brenda të errët dhe të freskët. Ajo ndezi një llambë dhe kërkoi kudo për monedhën, derisa e gjeti, për shkak se ajo ishte pjesë e prikës së saj.

Tek Luka 18, një vejushë paraqitet vazhdimisht tek një gjykatës i padrejtë. Çfarë lloji gruaje ishte ajo? A mos vallë ishte ndonjë grua e marrë, e cila nuk e dinte se kur të dorëzohej? Jo! Ajo ishte një grua që dinte të ishte ngulmuese. Ajo i njihte të drejtat e saj sipas Ligjit, dhe vazhdoi t'i kërkonte ato, derisa i mori.

Tek Luka 21, Jezusi dhe dishepujt ishin në tempull. Dishepujt ishin duke parë njerëzit e pasur që derdhnin çantat e tyre me florinj në arkën e thesarit. Papritur, Jezusi u thotë: "A e patë?".

Ata e pyetën: "Çfarë? Mos ishte ndonjëri me një çantë shumë të madhe që na shpëtoi nga sytë?".

Jezusi u tha: "Jo, jo. A e patë atë të moshuarën trupvogël?".

Dhe dishepujt u përgjigjën: "Aha, po, e pamë atë. Ajo hodhi vetëm dy monedha tek oferta".

Dhe Jezusi tha: "Ju nuk po kuptoni. Me të vërtetë nuk e kapni thelbin, apo jo? Të tjerët dhanë nga bollëku i tyre, por ajo dha gjithçka që kishte".

Një vejushë e papërmendur me emër, u kthye në një shembull të zemërgjerësisë që Perëndia pret nga të gjithë ne.

Në dallim të thellë me qëndrimet e kohës së sotme, Jezusi nuk është asnjëherë shfrytëzues i grave. Ai është i vetmi burrë që guxoi të fliste hapur me gruan tek pusi tek Gjoni 4. Duke bërë këtë gjë, ai i theu të gjitha standardet e kulturës së tij. E megjithatë, edhe ndërkohë që po i vinin në dukje gjithçka që ajo ishte - pra, një grua me martesë të shumta dhe me një jetë të pistë - ajo grua nuk u kërcënua asnjëherë nga Jezusi. Jezusi nuk e poshtëroi kurrë atë. Ai thjesht e ngriti nga papastërtia e saj dhe e veshi butësisht me drejtësinë e Atit të saj qiellor.

Dishepujt e Jezusit u kthyen tek pusi dhe gjetën mësuesin e tyre të nderuar duke folur me këtë grua. Gjoni na thotë: "Por asnjë nuk i tha: 'Çfarë kërkon?' ose: 'Pse flet me të?'" (vargu 27). Përse nuk e pyetën ata? Sepse tek Jezusi ekziston një lloj burrërie aq e përsosur, një siguri aq e përsosur në kuptimin e vet të burrërisë, sa që ai është i lirë nga mendësia burgosëse që thotë se duhet t'i ulësh gratë për të vërtetuar se je burrë.

Jezusi kurrë nuk frikësoi dhe as nuk kërcënoi

seksualisht ndonjë grua, dhe as nuk u kërcënua apo u frikësua ndonjëherë nga ndonjë grua. Jezusi nuk jepte vështrime të pahijshme apo ngacmime vulgare. Atij nuk i duhet që të vërtetojë ndonjë gjë, sepse ai është 100 për qind burrë.

Për këtë arsye si burrat, si gratë, tërhiqen njësoj drejt Jezusit. Ai lartësoi dhe konfirmoi çdo grua që erdhi tek ai. Gratë gjejnë tek ai, burrin, si i cili do të donin që të ishin të gjithë burrat e tjerë. Dhe burrat shohin tek ai, burrin, si i cili e dinë që duhet të jenë.

PËRMBYLLJA

Ne jetojmë në një botë e cila i portretizon nënat dhe gratë në përgjithësi me shumë sentimentalizëm të ekzagjeruar. Për Ditën e Nënave, ne iu dërgojmë kartolina, iu japim dhurata dhe ndoshta i nxjerrim nënat ose bashkëshortet tona për darkë në ndonjë restorant. Por, çfarë bëjmë ditën tjetër? I trajtojmë gratë sikur të jenë krijesa më inferore nga ne, të cilat duhen vetëm për gatim, për të pastruar shtëpinë dhe për të bërë fëmijë.

Nga ana tjetër, Jezusi e trajtoi nënën e tij, si edhe gratë e tjera, me respektin më të thellë të mundshëm. Ne i nderojmë të gjitha gratë duke iu treguar atyre të njëjtën dashuri dhe respekt që Jezusi tregoi ndaj grave.

Gratë janë poshtëruar dhe abuzuar nga burrat, ndonjëherë në mënyrë shumë të vrazhdë dhe të egër. Por Jezusi është burri i përsosur, burri, të cilin Perëndia dëshiron që çdo burrë ta imitojë. Ky është ai lloj burri të cilin Perëndia dëshiron që çdo grua ta njohë në jetën e saj.

SHËNIME

1. Disa nga Shkrimet e përdorura në këtë artikull janë të perifrazuara nga autori.
2. Kenneth E. Bailey, "Poet and Peasant Through Peasant Eyes" (Poeti dhe fshatari përmes syve të fshatarit) (Grand Rapids: William B. Eerdmans, 1983).



DOUG CLARK, ka qenë drejtori rajonal i Misioneve Botërore të Asamblesë së Perëndisë për Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut.





*M*ENTORIMI

I Panegociueshëm Për Fuqizimin e Grave në Shërbesë

**Libri i Ruthit ofron një model të
shkëlqyer ADN-je për të mentoruar
gra të tjera, duke pasur një qëllim.
Historia e saj na jep nëntë tipare të
karakterit të mentorimit të
qëllimshëm.**

Nga: **KAREN YANCEY**



ërvoja 10 ditore në mision shkoi shumë mirë. Patëm mundësi që të bënim shërbesa humanitare dhe shërbesa të mëshirës dhe si rezultat, shumë fëmijë, gra dhe familje të tëra, e pranuan Jezusin si shpëtimtarin e tyre.

Mes qeshjeve miqësore, përqafimeve të ngrohta dhe lotëve të singertë, skuadra e grave u përshëndet për herë të fundit me misionaren që i kishte mirëpritur. I hipëm avionit dhe rregulluam çantat tona për udhëtimin e gjatë që na priste. Ndërkohë që avioni u shkëput nga pista dhe filloi fluturimin e tij drejt shtëpisë, mendja ime iu rikthye edhe një herë dhjetë ditëve të fundit.

Isha e mahnitur se si Perëndia lejoi që 20 gra të zakonshme, me personalitete individuale dhe me pika të forta, të cilat ndryshonin nga njëra-tjetra, të shërbenin në mënyrë të palodhur për një javë e gjysmë pa u ankuar qoftë edhe një herë. I hodha sytë rrotull nëpër avion dhe numërova anëtarët e skuadrës. Shumica e tyre kishin rënë në një gjumë të thellë tashmë, i cili nuk ishte asgjë më shumë sesa rraskapitja e atyre ditëve.

E pozicionova trupin për të pushuar pak, pa pasur asnjë ide se pas pak do të ndodhnin disa çaste jetë-ndryshuese të Perëndisë, pikërisht aty, në rreshtin 39, në ulëset E dhe F. Sapo e mbështeta kokën në jastëkun që kishim marrë nga kompania ajrore, një nga anëtarët e skuadrës, e cila ishte ulur pranë meje, më pyeti nëse mund të flisnim. Jam shumë mirënjohëse që e shkunda veten nga ajo gjendje e turbullt e mendjes dhe thashë: "Patjetër!".

Në mirëbesim, ajo më tha: "Unë ndiej se jam e thirrur në shërbesë. A do që të jesh mentorja ime?".

Ajo pyetje e bërë para shumë vitesh, ndryshoi trajektorën e jetës së saj - si dhe të jetës sime. Ajo fitoi një mentore, ndërsa unë përjetova një zbulesë: që Perëndia kishte ndërtuar brenda meje - pavarësisht të metave të mia - një dëshirë të brendshme për t'u lidhur qëllimisht me gra të cilat përjetonin pasiguri në shërbesë dhe kishin etje për një formim të vazhdueshëm frymëror.

Mentorimi është një mundësi për gratë e reja në shërbesë që të mbushin "kovën" e tyre në rezervuarin e përvojës, sensibilizimit, pjekurisë dhe natyrës frymërore që ofrojnë shpeshherë gratë e sprovuara në shërbesë. Koncepti i mentorimit është bërë i pranueshëm në tri dekadat e fundit. E megjithatë, mbetet ende disi i paqartë kur vjen puna tek zbatimi praktik. A është mentorimi formal apo informal? A është ai i strukturuar apo i pastrukturuar? A është i qëllimshëm apo organik (i natyrshëm)? Për mua, mentorimi është të gjitha këto.

Unë nuk jam rritur në shërbesë me kohë të plotë, dhe babai im nuk ka shërbyer kurrë si dhjak apo plak kishe. Megjithatë, përkushtimi kuptimplotë i prindërve të mi ndaj Perëndisë, pjesëmarrja e tyre në takimet e kishës dhe besnikëria ndaj pastorëve tanë kanë siguruar për mua një themel të shëndetshëm në ecjen time frymërore.

Perëndia më ka thirrur në shërbesë kur isha 16 vjeçe. Kur isha 18 vjeçe u martova, dhe 19, linda fëmijën tim të parë, ndërsa në moshën e pjekur 22 vjeçare shërbeva si "zonja e parë" e shtëpisë së pastorit. Këto arritje në jetën time ndodhën shumë kohë përpara se ideja e mentorimit të shfaqej në radarin tim. Në retrospektivë, qoftë mbijetesën time në shërbesë, qoftë çfarëdo kontributi domethënës, ia atribuoj ekskluzivisht një Perëndie të gjithëpushtetshëm, i cili është më se i mjaftueshëm, dhe një bashkëshorti të jashtëzakonshëm.

PSE TË MENTOROJMË?

Ndërkohë që vitet ecin, edhe unë jam pjekur gradualisht në shërbesë. Tani, që jam një grua më e kalitur, i hedh sytë pas dhe hamendësoj se sa ndryshe do të kishte rrjedhur shërbesa ime në rast se gjatë atyre viteve do të kisha pasur një mentore pranë meje. A do ta kisha mposhtur më shpejt sabotimin që bëja duke urreyer veten time, i cili kishte ardhur si rezultat i krahasimeve të pashëndetshme dhe pritshmërive aspak realiste që kisha vendosur mbi veten? A do ta kisha menaxhuar më mirë habinë që të krishterët nuk sillen gjithmonë si të krishterë? A do të kisha qenë e pajisur për ta çliruar dhimbjen dhe acarimin që grumbullohej brenda meje kur njerëzit e trajtonin burrin tim në mënyrë të padrejtë? Pyes veten nëse do ta kisha kuptuar se mund të thosha "jo" herë pas herë pa u ndier në faj dhe pa dhënë shpjegime. Ndoshta një grua me më shumë përvojë në shërbesë mund të kishte qenë e qëllimshme që të më ndihmonte për të lundruar nëpër këto të panjohura në jetën time.

Po kur vjen puna te llogaridhënia për planin e leximit të Biblës, zakonet e studimit dhe për aftësinë për t'i interpretuar Shkrimet në mënyrë të saktë? A do ta kisha manovruar ndryshe kritikën për gratë që u japin mësim burrave nëse do të kisha pasur një mentore që do të më shoqëronte në rrugëtimin tim? Patjetër që po!

TË MENTORUAR NGA DISTANCA

Pasi u bënë disa vite në shërbesë, më kujtohet shumë qartë që Perëndia më sfidoi që të fokusohesha tek gra shërbenjëse të sprovuara, të cilat ishin shembulli tipik i cilësive të dëshiruara. Isha e

qëllimshme teksa vëzhgoja mënyrën se si silleshin në publik këto gra fisnike. Ato më mësuan që ta kërkoja Perëndinë në mënyrë të sinqertë, me gjithë zemrën dhe intelektin tim, jo thjesht me emocione. Ato më mësuan të jetoja jetë të plotë dhe të shenjtë, duke mos i kushtuar vëmendje kritikave të pabazuara ndërkohë që mbetesha e sjellshme dhe dashamirëse. Me anë të shembullit të tyre, ato i nderonin bashkëshortët që kishin përkrah, kërkonin ekuilibrin dinamik në familje dhe në shërbesë, dhe shërbenin në mënyrë altruiste. Ato visheshin me modesti, përdornin një fjalor që nuk e përfshinte të folurit me sarkazëm dhe i dëgjonin me vëmendje njerëzit që kishin përreth. Këto udhëheqëse të papërsosura, në mënyrë të pavetëdijshme, më mentoruan mua nga distanca. I njëjti mentorim kuptimplotë dhe i rëndësishëm, tani, në kohën që flasim, duket i pastrukturuar, informal dhe organik. Edhe pse jo me një kontekst të drejtpërdrejtë, ky mentorim informal krijoi në jetën time frytë që zgjasin.

Gjithsesi, mentorimi informal nuk e përjashton nevojën për një përqasje të qëllimshme dhe të strukturuar. Mentorimi i qëllimshëm premton “vaksinimin” e grave shërbenjëse kundër virusit të rrezikshëm të izolimit.

Lidhja që përftohet nga marrëdhëniet, ofron shtegun më domethënës të shërbesës që ia vlen të ndjekësh. Në njëfarë mënyre, në shoqërinë moderne, e kemi humbur spontanitetin që gjejmë në Bibël ku një person, i cili ka më shumë përvojë, ndihmon dikë tjetër që të fitojë aftësi ose të kuptuarit. Kompjuterët dhe interneti hapin një thesar të fshehur plot informacion, por eliminojnë aspektin e marrëdhënieve me anë të cilave mësojmë nga takimet ballë për ballë.



Në një botë ku Google, në dukje i gjithëdijshëm, mund të sigurojë informacion të pafund, disa njohuri merren më mirë përmes përvojës së marrëdhënieve.

MENTORËT KRIJOJNË NJË KULTURË

Mentorët themelojnë një lloj ADN-je të marrëdhënies. Në librin e Xhon Ortbergut (John Ortberg), me titull: “Të gjithë njerëzit janë normalë, derisa të arrini t’i njihni ata” (Everybody’s Normal Till You Get To Know Them) ai citon një studim mbi marrëdhëniet, të kryer përgjatë nëntë viteve, ku u vëzhguan 7 mijë vetë. Hulumtuesit zbuluan se njerëzit më të izoluar kishin një probabilitet tri herë më të madh për të vdekur, sesa ata që kishin lidhje të forta të marrëdhënieve. Njerëzit me zakone të pashëndetshme (p.sh. duhanpirja, zgjedhjet jo të mira të të ushqyerit, mbipesha apo konsumi i alkoolit), por me lidhje të forta sociale jetonin në mënyrë domethënëse më gjatë sesa njerëzit që kishin zakone shumë të mira të shëndetit, por që rrinin të izoluar. Me fjalë të tjera, është më mirë të hash ëmbëlsira me miq të mirë, sesa të hash brokoli i vetëm! Thelbi këtu duket i qartë: Ne kemi nevojë për marrëdhënie të forta dhe të qëllimshme. Përpjekja për ta kaluar jetën pa to, është e dëmshme.

Libri i Ruthit ofron një model të shkëlqyer ADN-je për të mentoruar gra të tjera, duke pasur një qëllim. Historia e saj na jep nëntë tipare të karakterit të mentorimit të qëllimshëm.

1. Naomi e nderoi autoritetin në jetën e saj. Në mënyrë të bindur, ajo e ndoqi bashkëshortin e saj në Moab (Ruthi 1:1, 2). Kishat “Asambleja e Perëndisë” mbajnë një qëndrim egalitar (të barazisë) kur vjen puna tek gratë që kanë pozicion udhëheqjeje në shërbesë (pra, një besim që, duke qenë se burrat dhe gratë janë një në Krishtin, atëherë nuk ka dallime gjinore kur bëhet fjalë për rolet funksionale në kishë), por kjo pikëpamje nuk iu jep të drejtë as femrave e as meshkujve të cilët uzurpojnë postin e autoritetit apo që krijojnë mosmarrëveshje dhe grindje në kërkim të të drejtave të tyre. Prandaj, mentorët duhet që, si fillim, të modelojnë nënshtrimin ndaj atyre që janë në autoritet.

2. Naomi i çmoi marrëdhëniet. Ajo e refuzoi izolimin, fillimisht duke ruajtur marrëdhëniet e rëndësishme, edhe teksa po duronte sprovat më të vështira të jetës. Bashkëshorti dhe djemtë e saj vdiqën në Moab (Ruthi 1:3-7). Ajo i mbajti afër nuset e saj, Orpahun dhe Ruthin, dhe ato e panë Naomin nga afër, ndërkohë që ajo po kalonte periudhën e pikëllimit të saj të papërshtueshëm.

Mentorët bëjnë mirë të kuptojnë se shembujt e tyre flasin në të gjitha stinët.



3. Naomi iu besoi rrënjëve të saj historike për përkrahje. Kur ishte koha e duhur, ajo u përgatit për t'u kthyer në Bethlehem (Ruth 1:7). Rrënjët e saj përfaqësonin të vërtetën se gjithmonë do të ketë nevojë për mentorë të cilët të ofrojnë mbështetje personale.

4. Naomi ishte e singërtë me veten dhe me të tjerët në lidhje me emocionet e saj. Kur ishte në kufirin mes dy vendeve, ajo shprehu dhimbjen e saj të brendshme më të madhe dhe ua rrëfeu hidhërimin që kishte në shpirt dy vajzave të reja (Ruth 1:11-13).

Mentorët e shëndetshëm zbulojnë, në mënyrë strategjike, shtresa të transparencës. Ata e kuptojnë që personat e mentoruar identifikohen shumë lehtë me

dhimbjen e një mentori. Sjellja e Naomit e kundërshton urtësinë tradicionale që thotë se drejtuesit nuk duhet t'i lejojnë kurrë ndjekësit e tyre të afrohen shumë. Por Naomi e lejoji këtë gjë; po kështu edhe Jezusi.

5. Naomi i njihte kufizimet e saj. Në gjendjen e saj të dëshpëruar mendore, ajo u bëri thirrje nuseve të saj të ktheheshin pas, duke e ditur se ajo nuk mund t'u jepte një bashkëshort (Ruthi 1:11, 12).

Në këtë pikë, Naomi e keqkuptoi atë për të cilën kishin nevojë më së shumti personat që mentoronte. Orpahu, qartësisht, e donte Naomin, por ajo doli nga marrëdhënia "mentor – e mentoruar" për shkak se Naomi nuk i jepte dot bashkëshortin për të cilin ajo mendonte se Orpahu kishte nevojë. Megjithatë, Ruthi



donte atë që Naomi mund t'i jepte, gjë e cila përfshinte: një Perëndi të vërtetë, një popull të zgjedhur dhe një vend në një familje të perëndishme.

Mentorët duhet të kuptojnë dhe të pranojnë gjërat që ata nuk mund t'i bëjnë. Por, mund t'i besojnë Perëndisë për të përmbushur qëllimet e Tij pavarësisht nga kufizimet e tyre.

6. Naomi investoi kohë tek Ruthi. Ajo e pranoi kërkesën e personit që mentoronte dhe e lejoi Ruthin të qëndronte afër dhe të kalonte kohë me të (Ruthi 1:16-18).

Mentorimi kërkon kufij personalë të modifikuar me qëllim, por duke ruajtur autonominë dhe identitetin personal (Ruthi 1:19).

7. Naomi i dha një këshillim të drejtpërdrejtë Ruthit. Ajo i ofroi asaj udhëzime specifike, duke i thënë Ruthit të shkonte në lëmë, si dhe atë që duhet të bënte atje (Ruthi 3:3).

Mentorët e shëndetshëm e kuptojnë se informacionet, shembujt dhe zbulimi i vetvetes kanë të gjitha vendin e tyre, por ata gjithashtu e dallojnë momentin kur personi i mentoruar ka nevojë për një orientim të qartë.

8. Naomi e shijoi shpërblimin e investimit të saj. Ajo mori një bekim unik si mentore besnike, kur mbajti në krahë nipin e saj, një fëmijë i cili u lind në familjen e mbretit David dhe të Jezus Mesias (Ruthi 4:13-22; Mateu 1:5, 6).

Mentorët e shëndetshëm e dallojnë se marrëdhënia mbart një potencial të fuqishëm të shumëfishimit frymëror.

9. Naomi dha fryt përmes jetës së një personi tjetër. Ruthi 4:14, 15 thotë: “Atëherë gratë i thanë Naomit: ‘Bekuar qoftë Zoti, që sot nuk të la pa një shpengues. Emri i tij u bëftë i famshëm në Izrael! Pastë mundësi ai të rimëkëmbë jetën tënde dhe u bëftë mbështetja e pleqërisë sate, sepse e ka lindur nusja jote që të do dhe që vlen për ty më tepër se shtatë bij’ ”.

Mentorët e shëndetshëm nuk marrin merita për arritjet e personit të mentoruar, por ata prehen në gëzimin që kanë kontribuar në suksesin e një burri/gruaje tjetër në shërbesë.

TRE LITARËT PËRCJELLIN FUQI

Marrëdhënia e Naomit me Ruthin tregon se: “Dy vlejné më mirë se një i vetëm. ... Në rast se dikush mund të mposhtë atë që është i vetëm, dy veta mund t’i qëndrojnë; një litar tresh nuk këputet aq shpejt” (Predikuesit 4:9, 12).

Libri i Predikuesit trajton çështje të vështira, të cilat kanë të bëjnë me jetën dhe me kërkimin e domethënies në sfidat tona të përditshme. Mësuesi merr në konsideratë zbrazëtinë e kaq shumë gjërave pas të cilave rendim. E megjithatë, koncepti kyç, fortësia e një litari tresh, meriton një studim nga afër. Kur Fija e Tretë hyjnore bëhet pjesë e ekuacionit, shpresa del në sipërfaqe. Përfshirja e Perëndisë në një marrëdhënie mes personit që mentoron dhe personit të mentoruar nuk garanton një miqësi për të gjithë jetën, por kur dy zemra qëndrojnë të hapura ndaj Frymës, personi që mentoron dhe personi i mentoruar gjejnë përfitime reciproke.

Gratë në shërbesë kanë nevojë për një litar tresh të mentorimit të përditshëm. Shumë njerëz, zakonisht kur përballen me sprova, vënë në veprim një plan individual për mbijetesë dhe ecin përpara për njëfarë kohe. Eventualisht, beteja të reja do të dalin, dhe trauma e përsëritur e vë poshtë personin. Kjo iu kujton besimtarëve për gjasat e mëdha se pa ndihmën dhe inkurajimin e të tjerëve, ata mund të mbijetojnë, por jo të lulëzojnë. Atëherë, mentorët duhet të hyjnë në rolin e inkurajuesit. Drejtuesit, si gra edhe burra, kanë nevojë për të tjerë në llogore, që të luftojnë bashkë me ta.

Perëndia ka vendosur një besëlidhje të re në zemrat tona. Premtimi i tij pa kushte na aftëson që të dëshirojmë për një jetë me një ekuilibër dinamik në vend të paqëndrueshmërisë. E megjithatë, gratë e reja shërbenjëse mund ta keqkuptojnë mungesën e parashikueshmërisë në shërbesë dhe të përballen

me paqëndrueshmëri dhe frikë. Shpeshherë ankthi fshihet në hijen e mendimeve tona. Zhgënjimi, acarimi dhe ankthi shpërthejnë kur këto gra ndiejnë se Perëndia i ka krijuar për më shumë se kaq. Ndoshta ato ndihen të pavlerësuara dhe të penguar në thirrjen e tyre. Ndërkohë që përballen me kritika dhe pengesa, këto gra kanë nevojë për inkurajim që të prodhojnë fryt në rolet udhëheqëse të shërbesës ku janë të thirrura nga Perëndia.

Themeluesit e Asambleve të Perëndisë kanë themeluar një organizatë me shërbenjës burra dhe gra, dhe me kisha, për të funksionuar si një rrjet. Që prej fillimit të Bashkësisë, përvojat e përbashkëta frymërore dhe përkushtimi në marrëdhëniet me njëritjetrin janë lartësuar pavarësisht gjinisë. Burrat dhe gratë në shërbesë kanë nevojë për marrëdhënie të shëndetshme.

Në një marrëdhënie mes personit që mentoron dhe personit të mentoruar, kur pjesëmarrësit e inkurajojnë njëritjetrin përmes llogaridhënies së vërtetë dhe mbështetjes që pasqyron stabilitetin e Perëndisë, edhe barrët e përbashkëta janë më të lehta. Një grua në shërbesë e cila qëndron e vetme, mund të sulmohet dhe të mposhtet, por dy gra, me Perëndinë në qendër, mund të qëndrojnë përkrah njëra-tjetrës dhe të kapërcejnë çdo barrierë.

Ajo gruaja në avion që më kërkoi ta mentoroja, mbetet një shoqe e mirë e imja edhe sot edhe kësaj dite. Gjatë pesë viteve të para të marrëdhënies sonë, ajo më shihte si mentoren e vet. Për shkak të afërsisë ku jetonim, ne kemi bërë shumë shëtitje mëngjesore së bashku dhe kemi ndarë jetën tonë. Ajo më ka bërë shumë pyetje, kemi bërë studime biblike së bashku dhe marrëdhënia u rrit dhe u kthye në një miqësi të cilën unë e vlerësoj shumë. Vite më vonë, po qëndronim së bashku në një aeroport, dhe unë e përçolla me lotët që më rridhnin nga sytë. E kisha mentoruar deri në pikën që ajo tani mund të drejtonte një skuadër grash në mision ndërkohë që unë, në mënyrë strategjike, qëndroja pas saj.

Etapat e fundit të mentorimit përfshijnë fuqizimin dhe çlirimin. Në fakt, ajo ditë në aeroport mbetet me të vërtetë një nga ditët më të çmuara të jetës sime. Ishte dita kur personi që mentoroja u kthye në kolege.



KAREN YANCY, drejtore e Departamentit të Zhvillimit të Rrjetit në Kansas, Rrjeti i Shërbesave të AP-së së Kansasit, në qytetin Mejz, Kansas.

Konferenca Kombëtare **BURRAVE** të tetor 2018

Burra të Perëndishëm në mes të një brezi të paperëndishëm

Nga: **FATJON KADIU dhe KURT PLAGENHOEF**

Më datë 13 tetor 2018, Asambleja e Perëndisë në Shqipëri organizoi për herë të parë Takimin Kombëtar të Vëllezërve.

Qëllimi i këtij takimi ishte nxitja e vëllezërve të kishave tona për t'iu përkushtuar edhe më shumë një jetese aktive lutjeje, shërbimi dhe perëndishmërie. Në këtë frymë, edhe tema për këtë takim ishte: *"Burra të perëndishëm në mes të një brezi të paperëndishëm"*. Ashtu siç tha Apostulli Pal: "Dua, pra, që burrat të luten në çdo vend, duke ngritur duar të pastra..." 1 Timoteut 2:8. Perëndia dëshiron që burrat të zënë vendin e tyre dhe të marrin përsipër rolin që Ai ka caktuar për ta që nga fillimi: për të udhëhequr, për të shërbyer


dhe për ta çuar përpara Mbretërinë e Perëndisë, përmes një jete të mbushur me lutje, duke pasur Krishtin si model. Ai dëshiron që burrat të jenë plot me Frymën e Shenjtë, në mënyrë që të jenë një dëshmi e fuqishme për Krishtin, në familjen, kishën dhe vendin ku jetojnë.

Në takim, mesazhi nga Fjala e Zotit, që u nda nga pastor Gëzim Spahija ishte i qartë e sfidues. Në thirrjen e altarit që pasoi, dhjetëra burra iu përgjigjën thirrjes për ta ripërkushtuar veten e tyre ndaj Krishtit. E gjithë koha që vijoi më pas, u përshkua nga një vajosje dhe frymë e fortë lutjeje. Prania e Frymës së Shenjtë ishte e fortë dhe veprimi i Tij dukej qartë.





Një vëlla nga kishëmbjellja e Asamblesë së Perëndisë në Sauk, derdhi zemrën e tij përpara Zotit në altar. Dikur ai kishte qenë mysliman dhe gjithmonë kishte besuar se Perëndia ekziston, por nuk kishte pasur një marrëdhënie personale me Të. Dy vjet më parë, motra e tij e kishte ftuar atë në kishë ku ai, për herë të parë në jetë, pati mundësinë që të dëgjonte ungjillin e Jezui Krishtit. E vërteta e Fjalës së Perëndisë që u predikua nga pastori në atë takim, pati një ndikim të fuqishëm tek ai, kështu që ai nisi t'i lutej Perëndisë. Ai i kërkoi Perëndisë që ta ndihmonte me punën dhe Zoti iu përgjigj duke i siguruar një punë të qëndrueshme, me një rrogë më të lartë. Kjo përgjigje lutjeje e ndihmoi atë që të bindej se Jezusi është i vërtetë. Gradualisht, të kuptuarit e tij u rrit e u zhvillua duke u bërë një besim i patundur në shpëtimin dhe jetën e re që ofrohet përmes Jezusit. Pavarësisht kundërshtimeve me të cilat u ndesh, dhe po ashtu edhe talljeve në punë, ai ka vazhduar që të qëndrojë i fortë në besimin e tij dhe t'i shërbejë Zotit. Gruaja, së bashku me dy djemtë e tij, gjithashtu kanë arritur të vijnë në besim tek Jezusi dhe po luten që edhe pjesa tjetër e familjes së tyre ta njohë Perëndinë. Atë natë, gjatë takimit të vëllezërve, tek altari, ai po kërkonte me zjarr Perëndinë për shpëtimin e familjes së tij.



Ai ndjeu Frymën e Perëndisë që të vinte mbi të dhe ta fuqizonte për të qenë një burrë i vërtetë, i cili është në gjendje të kujdeset për familjen e tij në mënyrë frymërore dhe fizike. Ashtu si ky vëlla, burra të tjerë po ngrihen që të zënë vendin e tyre në drejtimin frymëror dhe takimi i vëllezërve siguron një vend të sigurt në të cilin burrat mund ta hapin zemrën me sinqeritet dhe pa kurrfarë hipokrizie.

Gjithashtu, më pas patëm një kohë në grupe ku vëllezërit patën mundësi që të tregonin për sfidat, problemet dhe fitoret nga jeta e tyre. Ishte vërtet një kohë gjatë së cilës, pas lutjes në altar, u përjetua një liri dhe një unitet i vërtetë vëllazëror. E gjithë kjo pasdite e bekuar u mbyll me një darkë përbashkësie e miqësie me bekimin e Perëndisë.

Lavdi Perëndisë për veprën e Tij me vëllezërit. Lavdi Zotit për forcën, inkurajimin dhe hirin që Ai derdhi mbi ne. Pas kësaj kohe të bekuar, kemi pritshmëri edhe më të madhe duke pritur me besim për gjërat që Zoti ynë do të bëjë vitin e ardhshëm.

Le të rritet vepra e Zotit midis nesh. Le të rritet vepra e Zotit midis vëllezërve, në mënyrë që, me fuqinë e Frymës, të mund ta çojmë ungjillin në çdo cep të Shqipërisë!



KOLEGJI TEOLOGJIK UNGJILLOR

KTU ekziston që...

- të përgatisë mbjellës kishash, pastorë, misionarë dhe shërbëtarë të tjerë me dijen e Fjalës së Perëndisë dhe një shërbesë të efektshme në një kontekst pentakostal.
- të mësojë teologji të shëndoshë dhe të zhvillojë udhëheqës shërbëtorë.
- të avancojë ungjillin dhe të themelojë kisha pentakostale dhe të tjera ungjillore midis shqiptarëve dhe më gjerë në të tërë botën.



Për më shumë informacion, kontaktoni:
KTUShqiperi@gmail.com ♦ Cel.: 069 406 8956